



NJË STUDIM I KOSTOVE EKONOMIKE PËR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Tiranë, 2013



United Nations
ALBANIA

Titulli: Një studim i kostove ekonomike për zbatimin e legjislacionit shqiptar kundër dhunës në familje

Ky studim është përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women) në kuadër të Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016. Kontribut veçantë teknik ka dhënë dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Përgatitja dhe publikimi i këtij studimi është mbështetur financiarisht nga Qeveria Suedeze.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në studim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) ose të Kombeve të Bashkuara.

C: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Adresa: Rr.Vaso Pasha, Pall.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë

Përgatitën:

Prof.Dr. Av. Aurela Anastasi (Akademike e Asociuar)

Av. Besa Saraçi

Av. Aurela Bozo

Rezart Xhelo

Diana Zebi

Dorina Kulla

Bashkëpunëtorë: Debbie Budlender, eksperte ndërkombëtare.

Arti Grafik: Elvis Bejtja

Shtypur: Shtypshkronja Pegi

ISBN: 978-9928-162-67-0

BOTIME Botime Pegi: tel: +355/ (0)42 374 947; cel: +355/(0)69 40 075 02;

e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al



Shtypshkronja Pegi: cel: +355/(0)69 40 075 01;

e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Raport 1.

Mbi koston e zbatimit të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet Familjare”, për realizimin e detyrave të Policisë së shtetit, Prokurorisë së rrethit dhe gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Korçë dhe Kukës.

Ky raport u përgatit nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen e Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në kuadër të Projektit “Një studim i kostove të dhunës në familje në Shqipëri”, në kuadrin e Programit “Një UN” mbi Barazinë Gjinore (2008-2010).

Raport 2.

Mbi koston e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, në rrethet Vlorë dhe Korçë

Ky raport është hartuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në kuadrin e projektit: “Studim mbi koston e reagimit të bashkërenduar të komunitetit ndaj dhunës në familje në Shqipëri”, me mbështetjen financiare dhe teknike të Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri (UN Women), në kuadër të Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.

Parathënie

Njohja e kostove ekonomike e veprimtarive të institucioneve shtetërore, është e domosdoshme për buxhetimin që adresohet në zbatimin e legjislacionit kundër dhunës në familje. Prandaj, në këtë punim kemi paraqitur dy raporte studimore të cilat mundësojnë të dhëna mbi kostot e parandalimit dhe luftimit të dhunës në familje në Shqipëri, si dhe ndihmojnë në përlllogaritjet e shpenzimeve përkatëse.

Çështjet e barazisë gjinore dhe buxhetet në nivel qendror dhe vendor, për një kohë të gjatë, janë trajtuar si dy fusha të ndara nga njëra-tjetra. Por, vitet e fundit, gjithmonë e më tepër, po synohet përfshirja e standardeve të barazisë gjinore në buxhetin shtetëror. Për të kontribuar në këtë proces, pasi kostuam në mënyrë të pjesshme, shpenzimet për zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, menduam të kostojmë edhe shpenzimet e nevojshme për mirëfunksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje. Prandaj, keni në dorë një studim që përbëhet nga dy raporte: raporti i parë koston zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, kurse i dyti, koston mekanizmin e bashkërendimit dhe referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Në vitin 2006, kur në emër të Aleancës së organizatave jofitimprurëse, u paraqitëm në Parlament si përfaqësues të më tepër se 20000 zgjedhësve, iniciatorë dhe hartues të projektligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ishim të ndërgjegjshëm se, fakti që ne nuk e paraqitëm draftin, së bashku me një raport paraprak për përligjjen e

shpenzimeve financiare për zbatimin e tij, ishte një boshllëk jo pak i rëndësishëm. Kjo përbënte një mangësi serioze, parë që ai ligj nuk mund të vihej në jetë pa shpenzimet financiare për të gjithë rrjetin e institucioneve që ngarkoheshin me detyra, për zbatimin e tij. Sidoqoftë, deri më sot, zbatimi i këtij ligji është kryer përmes alokimeve të pjesshme të shpenzimeve nga Qeveria, ndërkohë që paraqitet si nevojë e domosdoshme kryerja e një studimi të plotë, me qëllim qartësimin e kostove të nevojshme për të gjithë aktorët, veçanërisht për Policinë, Prokurorinë, gjykatat, si dhe institucionet e tjera, pjesë e Mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës.

Ne shpresojmë se gjetjet e këtij studimi do të ndihmojnë në forcimin e veprimtarisë së autoriteteve përgjegjëse, do të rrisin efektivitetin e strukturave shtetërore, si dhe të shërbimeve për viktimat. Studimi do të ndihmojë për të rritur ndërgjegjësimin e institucioneve kompetente mbi kostot e dhunës në familje, për të promovuar më tej veprimet e tyre për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Gjetjet e studimit, do të ndihmojnë për alokimin e burimeve të nevojshme financiare për strukturat shtetërore përgjegjëse, si dhe për një ndërhyrje efektive të Organizatave jo fitimprurëse (OJF-ve) në nivel kombëtar.

Falënderime. Në emër të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe të hartuesve të të dyja raporteve studimore, dëshiroj të falënderoj në mënyrë të veçantë të gjithë gjyqtarët e prokurorët dhe punonjësit e policisë së Shtetit, të rretheve Tiranë, Durrës, Kukës, Korçë e Vlorë, për gatishmërinë e treguar në mbështetjen e ekspertëve të këtij studimi, duke dhënë informacione të sakta mbi veprimtarinë e kryer prej tyre.

Një falënderim i veçantë u drejtohet të mbijetuarve/ave të

dhunës në familje, që mbështetën grupin e ekspertëve për të llogaritur një kosto sa më reale të pasojave që vijnë për to dhe familjet përkatëse, nga zbatimi i ligjeve kundër dhunës në familje.

Gjithashtu, dëshirojmë të veçojmë në falënderimet tona edhe Znj. Debbie Budlender, e cila si eksperte e nivelit ndërkombëtar, me sugjerimet, materialet dhe përvojën që ofroi për grupin e punës, ndihmoi në përgatitjen e studimit tonë, në përputhje me standardet më të reja ndërkombëtare.

Së fundi, një falënderim i rëndësishëm shkon për partnerët dhe donatorët, Qeverinë e Suedisë, Entitetin e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) dhe Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD), që ideuan dhe mbështetën realizimin e këtij projekti.

Faleminderit të gjithëve,

Ju uroj një lexim të mbarë e të dobishëm!

Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi

Drejtoreshë Ekzekutive

RAPORT 1.

Mbi koston e zbatimit të Ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet Familjare”, për realizimin e detyrave të Policisë së shtetit, Prokurorisë së rrethit dhe gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Durrës, Korçë dhe Kukës

PËRMBAJTJA

1. Pse nevojitet kostimi i dhunës në familje në shqipëri?.....	6
2. Qëllimi i projektit.....	14
3.1 Dokumentet e strategjive dhe politikat.	15
3.2 Kuadri ligjor i brendshëm. Aktet ligjore e nënligjore.	18
3.3 Aktet nën-ligjore	20
4. Metodologjia e Studimit	23
5. Gjetjet e Studimit	23
6. Përfundime e sugjerime	39
Bibliografi	42
Shtojca I: Tabelat Sqaruese.....	43
Shtojca II: Pyetësorët e studimit (gjyqtarë, prokurorë, oficerë policie dhe viktime të DHF)	48

TABELA E SHIFRAVE

Grafiku 1:	Intervista të kryera në katër rrethe.....	25
Grafiku 2:	Nr. i UM gjatë studimit 3-mujor	29
Grafiku 3:	Kërkesat për Urdhëra Mbrojtje (UM) dhe Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM)	29
Tabela 1:	Shpenzimet e përlogaritura për një gjyqtar për rastet e dhunës në familje	33
Tabela 2:	Shpenzimet e përlogaritura për oficerët e policisë që i përgjigjen rasteve të dhunës në familje	36

LISTA E SHKURTIMEVE

1. Ligji kundër dhunës në familje - Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ligji kundër dhunës në familje.
2. VKM e mekanizmit të referimit - Vendimi i Këshillit të Ministrave, (VKM) nr.334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.
3. Konventa e CEDAW-t - “Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.
4. MPÇSShB - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
6. DHF – Dhuna në Familje
7. UMM – Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
8. UM – Urdhër Mbrojtjeje

1. Pse nevojitet kostimi i dhunës në familje në Shqipëri?

Ka mënyra të ndryshme për të kuptuar dhe trajtuar problemet sociale. Matja e kostove ekonomike të dhunës në familje është një teknikë e mundshme për të na ndihmuar të kuptojmë këtë çështje më mirë. Ajo tregon se si dhuna i shter burimet e shumë sektorëve përfshirë sektorin shtetëror, sektorin privat, agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare të ndihmës, grupet e komunitetit dhe individët. Dhuna në familje pengon zhvillimin ekonomik dhe social.

Matja e kostove të dhunës në familje, si dhe dhunës ndaj grave, i jep historisë njerëzore një magnitudë lehtësisht të kuptueshme dhe ndihmon që të ulet pranueshmëria sociale e dhunës.

Çdo studim¹ mbi kostot e dhunës në familje tregon që parandalimi dhe ndërhyrja e hershme kushton shumë më pak se sa kujdesi ndaj krizës në fazat e vonshme, si dhe ndaj pasojave të tjera sociale. Programet që zbulojnë dhe i japin fund dhunës në familje në një fazë të hershme, rezultojnë me kursime shumë të mëdha sociale në të ardhmen.

Kostimi i dhunës në familje në Shqipëri është i rëndësishëm edhe duke marrë parasysh shtrirjen e fenomenit dhe rritjen e vëmendjes nga institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore ndaj saj, në katër vitet e fundit. Studimi kombëtar “Dhuna në familje në Shqipëri²” tregon një përhapje në shkallë të lartë të dhunës në familje në të gjitha format ekzistuese, të tilla si, dhuna fizike, emocionale, psikologjike, seksuale, tradicionale dhe social-ekonomike. Kjo

1 Kostot Ekonomike të Dhunës Kundër Grave: Një Vlerësim i Literaturës, 2005

2 Një studim i kryer nga INSTAT në bashkëpunim me UNDP dhe UNICEF në Shqipëri, 2009

evidentohet edhe nga statistikat e policisë së Shtetit. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit raporton çdo vit, numrin e rasteve të denoncuar pranë organeve të policisë për dhunë në familje, si dhe të rasteve që janë dërguar në gjykatë. Gjithashtu, në përgatitjen e këtij studimi, jemi mbështetur edhe në gjetjet e raportit monitorues të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), të cilat regjistrojnë 406 vendime mbi lëshimin e urdhrave të mbrojtjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën korrik 2009 - qershor 2010.

Duke iu referuar të dhënave të Ministrisë së Brendshme, rezulton se numri i kërkesave për të lëshuar urdhra mbrojtje të menjëhershëm/urdhra mbrojtje të përgatitur nga strukturat e policisë dhe që i referohen gjykatave respektive për periudhën 2008-2010 është si më poshtë:

Viti 2008	377 kërkesa
Viti 2009	841 kërkesa
Viti 2010	1234 kërkesa

Rritja e numrit të kërkesave për urdhër mbrojtjeje ndaj dhunës në familje, tregon një tendencë që ka nevojë të shqyrtohet nga afër nga autoritetet publike, të cilat duhet të ofrojnë zgjidhje përmes burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare. Prandaj, njohja e kostove të dhunës lejon politikën dhe vendim-marrësit të masin efektivitetin e programeve kombëtare, strategjive dhe veprimeve që kanë për qëllim të reduktojnë dhunën dhe pasojat e saj. Studimi i koston së dhunës në familje në vetvete mund të ketë përfitime pozitive. Për studime të tilla duhet që të mblidhet një numër i madh të dhënash. Për shembull, informacioni dhe të dhënat mbi sa viktimë të dhunës në familje mund të përdorin një shërbim specifik në një qendër të caktuar të shërbimit shoqëror, shërben për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me luftimin e fenomenit të dhunës në familje. Ndërgjegjësimi për koston e

dhunës gjithashtu, forcon argumentet për ndërhyrjen e qeverisë, institucioneve të shërbimeve sociale, biznesit dhe komunitetit. Ai mund t'u japë organizmave përgjegjës informacion që do t'i ndihmonte ato në alokimet respektive në buxhetet e tyre, në lidhje me dhunën në familje.

Cila është kostoja e zbatimit të Ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”? Me çfarë kostosh përballlet një viktimë e dhunës në familje e cila kërkon një urdhër mbrojtje? Këto janë pyetje të cilat rrinë pezull pa gjetur përgjigje ndërmjet Policisë së Shtetit, Prokurorisë së rrethit, Gjykatave të rretheve gjyqësore dhe Institucioneve të Shërbimeve Sociale, që nga viti 2006, kur u miratua ligji. Mungesa e kostove, e shifrave dhe e studimeve përkatëse nuk mundëson një buxhet shtetëror të qëndrueshëm dhe efektiv, që do të zgjidhte fenomenin e dhunës në familje. Mungesa e buxhetit përkatës, të mjaftueshëm, ndikon në përgjigjen dhe në përgjegjësinë e Policisë së Shtetit, të Prokurorisë së Rrethit, të Gjykatave të rretheve gjyqësore ndaj fenomenit të dhunës në familje. Nga ana tjetër, mungesa e studimeve që lidhen me të sjell si rezultat mungesën e ndërgjegjësimit të duhur të publikut dhe të funksionimit të një përgjigjeje të koordinuar të komunitetit ndaj fenomenit të dhunës në familje. Njohja e kostove të dhunës në familje i lejon politikë-bërësit të masin efektivitetin e programeve që kanë për qëllim reduktimin e dhunës dhe të pasojave të saj shkatërruese. Në ditët tona, hartimi i politikave bazohet në fakte dhe studime mbi kostot e dhunës, të cilat i përfshijnë këto fakte. Për sa kohë që Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, si një strategji ndër-sektorale, nuk ka mekanizma financiarë të vetët, por varet nga disponueshmëria e fondeve nga alokimi i buxhetit të secilës ministri, lind nevoja për koordinimin e kontributeve të secilit institucion.

2. Qëllimi i projektit.

Qëllimi kryesor i projektit është, të ndihmojë në vlerësimin e një kostoje të përafërt të shpenzimeve që kryhen në Shqipëri për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, duke u bazuar në koston e shpenzimeve për aktorët: Policia e Shtetit, Prokuroria e rrethit, Gjykatat e rretheve gjyqësore, si dhe viktimat e dhunës në familje, të përfshira për zgjidhjen e një rasti dhune. Në këtë kuadër, synohet të ndihmohen organet shtetërore të pushtetit qendror e vendor në përlllogaritjet e shpenzimeve që parashikohen në buxhetet përkatëse, për parandalimin e luftimin e dhunës në familje. Për më tepër, studimi do të ndihmojë edhe për të rritur ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve mbi kostot e dhunës në familje dhe për të përkrahur më tej, veprimet përkatëse parandaluese dhe mbrojtëse.

Deri tani, nuk ka pasur një studim mbi kostot e dhunës në familje në Shqipëri. Disa studime të pjesshme, zbulojnë informacion të rëndësishëm se si viktimat e dhunës në familje përdorin shërbimet e Policisë së Shtetit dhe të Gjykatave të rretheve gjyqësore, por nuk japin informacion mbi kostot që lidhen me rastet e dhunës në familje. Për më tepër, një studim i tillë nuk u krye as në kuadrin e procesit të miratimit të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në vitin 2006³. Jo vetëm që do të kishte qenë një hap shumë pozitiv në atë kohë, por ishte edhe një detyrim i parashikuar nga Kushtetuta që nuk u përmbush plotësisht⁴. Prandaj, mendojmë se studimi që po paraqesim, i cili realizohet për herë të parë në Shqipëri, mbështet mundësinë për të zbuluar të dhëna të rëndësishme mbi kostot e dhunës në familje, pavarësisht nga kufizimet që mbart.

³ Raporti INSTAT “Studim mbi dhunën në familje në Shqipëri”, 2009.

⁴ Në nenin 82 të Kushtetutës vendoset: Propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij”.

Gjetjet e këtij studimi do të forcojnë veprimet e autoriteteve përgjegjëse dhe do të rrisin efektivitetin e strukturave shtetërore dhe të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje. Shpresojmë që ky studim të çojë në alokimin e burimeve të qëndrueshme financiare për strukturat përgjegjëse shtetërore dhe për ndërhyrje respektive të organizatave jo-fitimprurëse në nivel kombëtar. Organizatat jofitimprurëse mund të përfitojnë duke përdorur gjetjet e këtij studimi si një mekanizëm për advokasi, lobim, network, si dhe për strategji të tjera të përdorura prej tyre në adresimin e dhunës në familje në Shqipëri. Ne besojmë se, zbatimi i metodologjisë dhe i gjetjeve, do t'u shërbejë OJF-ve të tjera, për të kryer kostime në zonat në të cilat punojnë.

3. Politikat dhe kuadri ligjor mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.

3.1. Dokumentet e strategjive dhe politikat.

Qeveria Shqiptare me Vendim të Këshillit të Ministrave në dhjetor të vitit 2007 ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje për vitet 2007-2010, duke përfshirë këtu edhe një Plan Veprimi me ndërhyrje të specifikuara. Përmirësimi i mbrojtjes dhe i përgjigjes së organeve gjyqësore për viktimat e dhunës në familje ishte një nga objektivat kryesore të strategjisë.

Vlerësimi i kësaj strategjie në vitin 2010 tregoi se, kjo strategji kishte shënuar arritje në rritjen e ndërgjegjësimit dhe të

përgjegjësisë së institucioneve shtetërore në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare; megjithatë, vlerësimi tregoi gjithashtu, se ka akoma mjaft për të bërë.

Me iniciativën e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MÇSSHB) strategjia ishte e hapur për rishikim në vitin 2010. Rishikimi i strategjisë kishte për qëllim t'u përgjigjej zhvillimeve dhe kërkesave aktuale, në mënyrë që të forcoheshin ato veprime të cilat synonin krijimin e një shoqërie të barabartë. Strategjia e rishikuar u ndërtua mbi analizën dhe trajtimin e dy çështjeve kryesore: barazisë gjinore dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore. Përmirësimi i mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, përgjigjja e autoriteteve publike me fokus në punën parandaluese, duke adresuar shkaqet e dhunës në familje dhe abuzimet në familje dhe në shoqëri, mbetet një nga qëllimet kryesore të rishikimit të strategjisë.

Vërejtjet⁵ e Komitetit të CEDAW në lidhje me Raportin e tretë periodik të Shqipërisë, të paraqitur në korrik të vitit 2010, kanë shtruar detyra të reja në lidhje me aplikimin direkt të konventës CEDAW në legjislacionin e vendit, si dhe në lidhje me harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit aktual me Konventën CEDAW. Kjo, lidhet veçanërisht me mënyrën se si ligjet adresojnë forma të ndryshme të diskriminimit që ndikojnë tek gratë, kur këto u përjasin minoriteteve etnike, grave me aftësi të kufizuara, grave në zonat rurale, apo grave që vijnë nga grupe të tjera të disavantazuara, si dhe me forcimin e sanksioneve për aktet e diskriminimit. Është e nevojshme të shtohen përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e grave rreth zbatimit të legjislacionit ndaj rasteve të diskriminimit gjinor, si dhe të monitorohen përpjekje të tilla.

5 Vërejtjet përmbyllëse të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, Shtator 2010

Komiteti i CEDAW-t ka shprehur shqetësimin mbi përhapjen e lartë e të vazhdueshme të dhunës kundër grave në Shqipëri. Veçanërisht ai ishte i shqetësuar që dhuna në familje nuk sanksionohet dhe penalizohet siç duhet, dhe se përdhunimi martesor nuk përcaktohet si vepër penale e veçantë në Kodin Penal. Komiteti rekomandoi që, Pala shtetërore të forconte përpjekjet e saj për të siguruar që viktimat femra të dhunës të kishin një mbrojtje të menjëhershme, përfshirë edhe mundësinë e largimit të dhunuesit nga shtëpia, mbështetje efektive në qendra pritjeje dhe akses për një ndihmë ligjore dhe këshillim psikologjik falas. Aktualisht, ka një përmirësim të dukshëm të legjislacionit penal shqiptar, i cili ka përmbushur standardet ndërkombëtare të mbrojtjes nga dhuna në familje, sikurse ka rekomanduar Komitetit i CEDAW-t. Konkretisht, pas vërejtjeve përmbyllëse të komitetit në shtator të vitit 2010, u miratuan shtojcat në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, të cilat parashikuan ndëshkimin e dhunës në familje si një vepër penale e parashikuar shprehimisht në kod. Gjithashtu, u parashikuan një sërë veprash të tjera penale që lidhen me ndëshkimin dhe luftimin e dhunës në familje në Shqipëri⁶.

Të tjerë gurë themeli të rëndësishëm, që sigurojnë që Shqipëria të bëjë progres në zbatimin e politikave dhe veprimeve jo-diskriminuese janë:

- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW)
- Platforma e Pekinit për Veprim e vitit 1995 dhe dokumentet e mëtejshme;
- Komiteti për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW);

6 Shih "Kodi Penal i RSh", i ndryshuar (ndryshimet e vitit 2012, 2013).

- Vërejtjet përmbyllëse paraqitur nga Komiteti CEDAW në sesionin e 46-të të mbajtur në New York në datat 12-30 korrik 2010;
- Rezoluta e Këshillit të Sigurimit nr. 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë;
- Marrëveshja e Asociim Stabilizimit (SAA)⁷;
- Strategjia e BE për Barazinë ndërmjet Grave dhe Burrave për periudhën 2010-2015;
- Strategjia lokale për zbatimin e udhëzimeve të BE mbi dhunën kundër grave dhe vajzave, si dhe mbi luftën ndaj të gjitha formave të diskriminimit kundër tyre, e miratuar nga kryetarët e misionëve të BE në Shqipëri.

3.2. Kuadri ligjor i brendshëm. Aktet ligjore e nënligjore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon se martesë dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit (neni 53/2). Gjithashtu, një vëmendje të posaçme i ka kushtuar mbrojtjes së fëmijëve. Këta të fundit, së bashku me të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, gjithashtu (neni 54/1). Kur flasim për mbrojtjen e veçantë të shtetit, kjo do të thotë një rregullim juridik i plotë dhe me prioriteti statusit për këto subjekte, me anë të ligjit ose akteve të tjera nënligjore. Në këtë kuadër, mendojmë se mbrojtja nga dhuna duhet të zërë një vend të rëndësishëm. Për më tepër, për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi, Kushtetuta angazhohet edhe shprehimisht kur thekson: “Çdo

⁷ Marrëveshja e Asociim Stabilizimit e Republikës së Shqipërisë me Komunitetin Evropian dhe Shtetet Anëtare ka për qëllim të mbështesë përpjekjet e Republikës së Shqipërisë për të konsoliduar demokracinë dhe sundimin e ligjit. Respekti për parimet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut përbën një element kyç të kësaj marrëveshje.

fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë...” (neni 54/3).

Në lidhje me këto detyrime, ka një bazë ligjore të gjerë, e cila është përmirësuar mjaft në 10-vjeçarin e fundit. Por, nisur nga fokusi dhe qëllimi i këtij studimi ne do të evidentojmë vetëm disa sanksionime ligjore që përcaktojnë detyrimet e organeve shtetërore, në bazë të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, është baza ligjore për të adresuar dhunën në familje. Qëllimi i tij është që, të garantojë mbrojtje përmes masave ligjore ndaj anëtarëve të familjes të cilët janë subjekti i dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ligji dhe amendimi i tij, respektivisht në 2007 dhe në 2010, është një hap i madh përpara, për plotësimin e kuadrit ligjor në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW). Dy ligje të tjera që përbëjnë gjithashtu, një bazë për ndërhyrje kundër dhunës në familje në Shqipëri janë: Ligji Nr. 9970, i datës 24.07.2008, “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” dhe Ligji Nr. 10221, i datës 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Për sa më sipër, në punën tonë për përlogaritjen e kostove ne do të mbajmë parasysh ligjin në këto çështje kryesore:

Së pari, ai përcakton organet e administratës publike, të cilat kanë detyrimin dhe kompetencat për t’iu përgjigjur dhunës në familje.

Së dyti, ligji përcakton gjykatat që lëshojnë një urdhër mbrojtjeje (UM), ose një Urdhër të Menjëhershëm

Mbrojtje (UMM), si një instrument plotësues ligjor në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

Së treti, Ligji autorizon policinë e Shtetit dhe Prokurorinë e rrethit të kërkojnë dhe të ndjekin urdhrin e mbrojtjes, me ose pa dëshirën e viktimës.

Së katërti, ndryshimet shtojcat që iu bënë ligjit në vitin 2010. Zbatimi i këtij ligji brenda 3 viteve solli nevojën për ta amenduar atë⁸. Amendime dhe ndryshime të tilla përfshijnë: ngritjen e strukturave përgjegjëse, të shërbimit kombëtar dhe të qendrës për kujdesin social ndaj viktimave të dhunës në familje.

Ngritja e një Qendre pritjeje për viktimat e dhunës në familje, përmes amendimeve të vitit 2010 dhe rregullimit ligjor të sistemit të reagimit të koordinuar të komunitetit dhe të referimit të rasteve të dhunës në familje, është një tjetër gur themeli në përpjekjet e vendit për të luftuar fenomenin e dhunës në familje.

3.3 Aktet nën-ligjore

Këshilli i Ministrave ka ngritur mekanizmin e koordinimit dhe të referimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë këtu edhe mënyrat e procedimit për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. Ky mekanizëm nuk është objekt i kostimit në këtë studim, pasi do të kostohej në një studim të veçantë. Megjithatë, është e nevojshme të sjellim në vëmendje disa akte nënligjore për zbatimin e ligjit, me qëllim që të arrijmë në konkluzionet e duhura për koston.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) është aktori kryesor përgjegjës, parashikuar në

⁸ Ligji Nr. 10329 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, datë 30 shtator 2010.

ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” për të ndërmjetësuar bashkëpunimin e institucioneve shtetërore për të parandaluar dhunën në familje. Megjithatë, MPÇSSHB ka miratuar vetëm pak akte nën-ligjore, të tilla si: Marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ndërmjet MPÇSSHB, MB, MD, MSH dhe MASH, në 14 nëntor 2008. Një marrëveshje e tillë përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha ministrive në përputhje me ligjin, duke përfshirë zhvillimin e një Plani Pune Vjetor të Përbashkët, me linja buxheti konkrete për zbatimin e aktiviteteve që lidhen me dhunën në familje. Kjo marrëveshje ka një vlerë të veçantë, sepse ajo nxit ministritë e linjës për të krijuar linja të qarta buxheti për zbatimin e aktiviteteve që adresojnë fenomenin e dhunës në familje.

Ministria e Brendshme (MB) është një nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ka një vendim të Ministrit të Brendshëm Nr. 379, i datës 3 mars 2008, “Masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje” si dhe një Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. 981, i datës 31 tetor 2008, “Masat që do të merren nga Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare”. Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka hartuar një manual “Procedurat Standarde që duhet të zbatojë punonjësi i Policisë së Shtetit në marrjen e masave për parandalimin e dhunës, mbrojtjen dhe kujdesin për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili përfshin detyrat, detyrimet dhe procedurat që një punonjës i policisë duhet të ndjekë për të siguruar rendin publik, për të parandaluar krimin, për të hetuar, për të mbrojtur dhe për t’u kujdesur për viktimat

e dhunës në familje, si dhe për të zbatuar urdhrat e mbrojtjes. Pranë organeve të policisë së shtetit janë ngritur struktura të specializuara për të ndjekur çështjet e dhunës në familje. Është ngritur dhe funksionon Sektori i “Mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje” brenda Departamentit të Hetimit të Krimit. Në nivel lokal ka seksione të ngjashme brenda strukturës së disa bashkive. Sektorët për “Mbrojtjen e të miturve dhe dhunës në familje” ekzistojnë brenda strukturave të Drejtorive të Policisë së Qarkut të Policisë së Shtetit.

Ministria e Shëndetësisë ka lëshuar Urdhrin Nr. 13, të datës 23 janar 2008, “Për pajisjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare me raportin mjekësor përkatës”; Urdhrin Nr.14, të datës 23 janar 2008, “Për evidentimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në regjistrin dhe në kartelën individuale për viktimat e dhunës në familje”; dhe Urdhrin Nr.15, të datës 24 janar 2008, “Për trajtimin mjekësor në institucionet shëndetësore publike të personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare”.

3.4 Mekanizmi shtetëror i adresimit të dhunës në familje

Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” parashikon dy lloje të autoriteteve përgjegjëse, autoritete administrative dhe gjyqësore. Gjithashtu, mekanizmi u ngrit për të zbatuar rekomandimet e Komitetit CEDAW dhe të Platformës së Pekinit për Veprim. MPÇSSHB është autoriteti kryesor përgjegjës me një rol koordinues, mbështetës dhe mbikëqyrës. Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen në MPÇSSHB është e përbërë nga dy sektorë: Sektori për Barazinë Gjinore dhe Masat ndaj Dhunës në Familje dhe Sektori për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

Autoritete të tjera përgjegjëse si Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe pas amendimeve të vitit 2007, edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës adresojnë çështje të dhunës në familje përmes strukturave nën juridiksionin e tyre dhe në përputhje me kompetencat e parashikuara në këtë ligj. Përveç këtyre autoriteteve qendrore, ligji parashikon një numër detyrash për autoritetet lokale gjithashtu.

Gjykatat e rretheve gjyqësore. Përgjegjësitë e gjykatave të rretheve gjyqësore janë të lidhura ngushtë me gjykimin dhe lëshimin e Urdhrit Mbrojtës dhe Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe të ligjeve të tjera si ai, “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”. Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” rregullon procedurat për lëshimin e Urdhrave të Mbrojtjes dhe Urdhrave të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Dinamika e zbatimit të nenit 10 të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” gjatë periudhës 2008-2010, tregoi qartë përmirësimin e zhdërvjelltësisë së gjyqtarëve në sigurimin e masave mbrojtëse, me qellim forcimin e efektivitetit të Urdhrave Mbrojtës.

4. Metodologjia e Studimit


Në ditët tona është e dukshme se dhuna në familje prek të gjitha aspektet e shoqërisë dhe meqenëse pasojat janë shumësektoriale, kostot janë të përhapura në të gjithë ekonominë. Prandaj, duhet të mblidhen të dhëna nga burime të ndryshme. Fokusi i këtij studimi është shqyrtimi i të dhënave dhe i kostos që lidhet me rastet e dhunës në familje, d.m.th. kosto e përlogaritur për aktorët shtetërorë që vijnë: Policia e

Shtetit, Prokuroria e Rrethit, Gjykatat e Rrethit Gjyqësor; si dhe për viktimat e përfshira gjatë shqyrtimit të rasteve të dhunës në familje. Megjithatë, ky studim nuk ka mbuluar dhe analizuar kostot e shkaktuara nga administrata e gjykatave, nga sekretaritë, nga zyrtarët që paraqesin fletëthirrjet tek i padituri, etj. Kjo, jo për shkak të mungesës të dhënave specifike dhe të regjistruara nga institucionet e përcaktuara dhe, as për shkak se kosto të tilla janë konsideruar jo të rëndësishme nga anketuesit. Vlerësimet e diskutuara në këtë raport nuk janë vlerësime gjithëpërfshirëse të kostove aktuale të rasteve të dhunës në familje, por janë vlerësime shumë të kujdesshme të atyre kostove direkte të aktorëve të vijës së parë, që merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje deri në dhënien e vendimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor.

Megjithëse vlerësimet janë të kujdesshme, studime të ngjashme në vende të ndryshme tregojnë që kostot e dhunës në familje janë në miliona dollarë në vit. Si shembull, shqyrtojmë rastin e gruas, e cila i drejtohet policisë ose urgjencës mbas aktit të dhunës. Marrja në telefon e policisë përkthehet në orë pune të oficerëve të policisë dhe ngarkesë administrative, ndërsa shtrimi në pavijonet e urgjencës përkthehet në punë të stafit përkatës, në shërbime teknike të tilla si, analiza mjekësore, mjekim, shtrim në spital, etj.

Ky studim mbulon katër rrethe të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Korçë dhe Kukës. Në të katër rrethet, intervistat janë kryer me prokurorë, gjyqtarë, punonjës policie dhe me viktimat e dhunës në familje, siç tregohet në grafikun 1.

Grafiku 1: Intervista të kryera në katër rrethe



Zgjedhja e të intervistuarve u bazua tek numri i personelit që merret me trajtimin e rasteve të dhunës në familje në institucionet e përmendura më sipër.

Metodologjia dhe procesi i vlerësimit përshin hartimin e katër pyetësorëve (shtojca II), punën në terren për shpërndarjen e tyre, plotësimin dhe mbledhjen e tyre, hedhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre. Të gjithë pyetësorët përfshinin pyetje të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar. Variablat e përdorur për të gjithë pyetësorët dhe për të gjitha grupet e interesit janë koha dhe lekët. Duke përcaktuar kohën e harxhuar nga aktorët që merren drejtpërdrejt me zgjidhjen e rasteve dhe me reagimin ndaj dhunës në familje, kemi bërë një hap përpara për të përcaktuar burimet jo financiare që nevojiten për të përballuar fenomenin e dhunës në familje dhe zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Kostot japin një pamje të qartë të burimeve financiare dhe të buxheteve që nevojiten për të forcuar kapacitetet organizative dhe institucionale të aktorëve kryesorë. Gjithashtu, gjetjet sigurojnë të dhëna për variabël të kombinuar, për shembull (koha, kosto), “kosto totale e të gjitha Urdhrave të Mbrotjtjes në një periudhë 3 mujore”, duke përfshirë këtu kostot e përlllogaritura për një institucion të dhënë (të caktuar) mbi baza

tre-mujorësh dhe mbi bazën e numrit të rasteve të ndjekura për këta muaj.

Përgatitja e pyetësorëve për gjyqtarët është bërë duke mbajtur parasysh veprimet që ata kryejnë në një proces gjyqësor bazuar në Kodin e Procedurës Civile si dhe kërkesat e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, me synimin që gjetjet dhe rekomandimet të jenë brenda kontekstit të ligjit.

Në përgatitjen e pyetësorëve për punonjësit e policisë është mbajtur parasysh që pyetjet të jenë në përputhje me punën e tyre, si dhe me detyrat e punonjësit të policisë që burojnë drejtpërsëdrejti nga Ligji, me synimin që gjetjet të jenë burim i analizës së kohës së shpenzuar nga një punonjës policie për hapat e kryera prej tij në menaxhimin e një rasti të thjeshtë, tipik apo të komplikuar, si dhe të kohës së shpenzuar prej tij për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të urdhrave të mbrojtjes.

Në përgatitjen e pyetësorëve për viktimat e dhunës në familje është mbajtur parasysh se ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” parashikon që viktima të asistohet nga avokatë pa pagesë, kështu nuk është llogaritur kostoja për shërbimin ligjor. Prandaj, janë trajtuar në formën e pyetjeve të hapura faktorë të tillë si, koha e shpenzuar prej saj në komisaratin e policisë, koha në gjykatën e rrethit gjyqësor, koha e shpenzuar për të përfituar shërbime të tjera, shpenzimet për transport, shpenzimet mjekësore, si dhe paga për ditët e punës të humbura për shkak të nevojës për të marrë këto shërbime.

Pyetësorët u përgatitën me kujdes nga ekipi i ekspertëve kombëtarë me njohuri të thelluara në çështjet ligjore, dhunën në familje, barazinë gjinore dhe në financë. Ekipi i ekspertëve punoi

ngushtësisht me Znj. Debbie Budlender, eksperte ndërkombëtare me njohuri të gjera në kostimin e DHF.

Mbledhja e të dhënave përmes pyetësorëve nga të gjitha grupet e të intervistuarve rajonale u krye gjatë periudhës mars – maj 2011.

U organizua një tryezë e rrumbullakët teknike për të prezantuar gjetjet paraprake të studimit në qershor të vitit 2011. Morën pjesë dhe kontribuan oficerët e policisë, gjyqtarët, prokurorët, ekspertët e DHF dhe përfaqësuesit e shërbimeve sociale.

Kufizime:

Katër pyetësorët u detajuan mirë për të nxjerrë maksimumin e informacionit gjatë intervistave. Megjithatë, në disa raste të intervistuarit nuk kishin informacion të hollësishëm për të plotësuar pyetësorin dhe në disa raste, i anashkaluan disa pyetje.

Në total ishin 64 pyetësorë. Të dhënat janë grumbulluar sipas grupeve të synuara dhe sipas rretheve. Koha mesatare për një rast të dhunës në familje është llogaritur për çdo rreth dhe për çdo grup të synuar. Koha mesatare e shpenzuar është llogaritur për një rast të vetëm të dhunës në familje, duke përfshirë këtu kohën e harxhuar nga një prokuror, nga një punonjës policie, nga një gjyqtar, si dhe kohën e harxhuar nga viktimat e dhunës. Kostoja për një rast të vetëm të dhunës në familje është vlerësuar bazuar në kohën e harxhuar dhe në pagesën mesatare të të gjithë aktorëve të përfshirë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Kur një situatë e caktuar nuk ndodh në të gjitha rastet, vlerësimet për kohën që lidhet me të janë përshtatur për të reflektuar përqindjen e rasteve në të cilën ndodh kjo situatë.

Siç u vu në dukje, studimi u krye vetëm në katër rrethe dhe gjetjet ishin shumë të ndryshme nga një rreth në tjetrin. Për një

pasqyrim më të mirë të kostove që hasen kur trajtohet një rast të dhunës në familje nevojitet një mbulim më i mirë i rretheve në Shqipëri, veçanërisht duke përfshirë në studim ato rrethe me kulturë, zakone, zhvillim ekonomik-shoqëror dhe me tipare të pozitës gjeografike të ndryshme.


Ndër kufizimet mund të rendisim edhe faktin e prezantuar nga pjesëmarrësit në tryezat e projektit, të cilët nënvizuan se, jo të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe punonjësit e policisë janë të trajnuar mbi çështjet e DHF dhe me kërkesat e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, prandaj disa prej tyre, veçanërisht në rrethet e largëta, kanë nevojë për trajnime në lidhje me zbatimin e LDHF.

5. Gjetjet e Studimit


Gjatë një periudhe studimore tre-mujore kanë ndodhur 101 raste të dhunës në familje, të cilat janë trajtuar nga gjyqtarët, punonjësit e policisë dhe prokurorët. Grafiku 2 tregon që përhapja e dhunës në familje ndryshon shumë nga rrethi në rreth.

Viktimat e dhunës në familje kanë të drejtën të kërkojnë mbrojtje ligjore, akses në drejtësi dhe të kërkojnë urdhër mbrojtje, ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje në gjykatat e rretheve gjyqësore. Gjetjet tregojnë se në 71 përqind të rasteve, viktimat e dhunës në familje kanë kërkuar UMM dhe në 29 përqind të rasteve kanë kërkuar UM. Vetëm në 20 % të rasteve të UMM që kanë lëshuar gjykatat, ka vazhduar procesi gjyqësor për verifikimin e UMM dhe lëshimin e UM.

Grafiku 2: Urdhrrat e Mbrojtjes gjatë periudhës 3-mujore



Grafiku 3: Kërkesa për UM dhe UMM



Gjykatat e Rretheve Gjyqësore

Intervistat me gjyqtarët⁹ paraqitën informacion dhe të dhëna të dobishme. Analiza e pyetësorëve na çoi në gjetje, në lidhje me kohën që harxhon një gjyqtar për secilin hap procedural në procesin gjyqësor (shtojca I), në lidhje me faktin se, si faktorë të

9 Të intervistuar janë gjyqtarë nga Gjykatat e rrethit Gjyqësor, “Seksioni Familjar”, që merren me rastet e DHF.

ndryshëm e zgjasin ose e shkurtojnë kohën e procesit gjyqësor, si dhe mbi opinionet e hapura të gjyqtarëve në lidhje me zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. U evidentuan disa tipare të përbashkëta:

Së pari, çështjet e dhunës në familje që kanë si objekt lëshimin e urdhrave të mbrojtjes janë gjykuar nga gjyqtarët e “Seksionit Familjar”, të cilët gjithashtu, gjykojnë çështje të tjera familjare.

Së dyti, një gjyqtar gjatë gjykimit, shpenzon më shumë kohë që të dëgjojë të dyja palët (autorin dhe viktimën) krahasuar me hapat e tjerë të procesit gjyqësor. Koha mesatare që një gjyqtar harxhon për të dëgjuar të dyja palët është 1 orë e 24 minuta.

Në një rast të dhunës në familje kërkohet të provohen faktet e pretenduara nga viktimat, gjë që përbën një nga veprimet më të rëndësishme procedurale gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Prezenca e provave shpresore të tilla si, shënime të doktorëve, raport mjekësor, dëshmi nga dëshmitarët, etj., nuk është e detyrueshme me ligj, por është një mundësi për të ndihmuar gjykatën që të marrë një vendim. Kur mungojnë provat, pasi ka dëgjuar të dyja palët dhe bindet, gjykata e lëshon një Urdhër Mbrojtjeje bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe të fakteve në të cilat ka ndodhur dhuna.

Gjatë intervistave, disa gjyqtarë shpjeguan se ka raste kur viktimat nuk janë në gjendje të shpjegojnë faktet, situatën dhe rrethanat në të cilën ndodhi dhuna, prandaj gjyqtarët duhet të harxhojnë më shumë kohë për t'i drejtuar të dyja palët, që të shpjegojnë me detaje ngjarjen, me qëllim që të krijojnë një pamje të qartë të ngjarjes para vendimit. Në këtë rast, roli i avokatit është i vlefshëm për të ndihmuar të dyja palët që të japin dëshminë e tyre bazuar

në kërkesat ligjore, për ta bërë gjykimin më efektiv dhe seancat e shqyrtimit gjyqësor më të shkurtra.

Së treti, analiza e të dhënave tregon se një hap i rëndësishëm, i cili merr shumë kohë gjatë procesit gjyqësor është koha për të përgatitur vendimin përfundimtar të gjykatës. Arsyetimi i tij, është një moment i rëndësishëm i procesit gjyqësor. Argumentet mbi faktin e ndodhur, faktet se pse gjykata krijon bindjen se fakti ka ndodhur dhe se viktimja ka nevojë të mbrohet me urdhër mbrojtje, janë shumë të rëndësishme për t'u përshkruar në pjesën arsyetuese të vendimit. Urdhërimet e gjykatës në lidhje me masat mbrojtëse të vendosura në përputhje me situatën, faktet e ndodhura dhe nevojën për mbrojtje të viktimës, urdhërimet për adresimin e vendimit në lidhje me ekzekutimin e tij sipas kërkesave të ligjit, e angazhojnë gjyqtarin në një kohë relativisht të gjatë, në raport me kohën që harxhon për hapat e tjerë që ndjek në një proces gjyqësor.

Vlerësohet që një gjyqtar shpenzon rreth 1 orë e 15 minuta për të përgatitur vendimin gjyqësor.

Së katërti, periudha dhe afatet kohore kanë shumë rëndësi dhe janë vendimtare në një proces gjyqësor për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes dhe për efektivitetin e zbatimit të ligjit kundër dhunës në familje. Gjyqtarët identifikuan një numër të vogël faktorësh që zgjasin ose shkurtojnë procesin gjyqësor. Për shembull, fakti që autori e mohon dhunën, megjithëse kjo ndeshet në 64 % të rasteve të dhunës në familje, nuk ndikon në kohën që i duhet procesit gjyqësor. Në rastin kur

autori nuk ka marrë njoftim nga gjykata për shkak të një adrese jo korrekte, kjo konsiderohet vonesë në procesin gjyqësor dhe kjo ndodh në 34 % të rasteve.

Përpjekja për të provuar forma specifike të dhunës, të tilla si dhuna ekonomike, psikologjike, seksuale, etj., konsiderohet nga gjyqtarët si një faktor, i cili merr kohë në një proces gjyqësor. Adresat e sakta të të dyja palëve, prezenca e të dyja palëve në procesin gjyqësor, si dhe e provave bashkëngjitur kërkesës, janë faktorët të cilët e përshpejtojnë procesin gjyqësor.

Gjejmë se, mesatarisht, koha që një gjyqtar harxhon për të lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtje është 1 orë e 10 minuta.

Mesatarisht, koha totale që një gjyqtar harxhon për një rast të dhunës në familje është 7 orë e 18 minuta.

Gjatë periudhës tre mujore të studimit, mesatarisht, një gjyqtar ka shpenzuar 182 orë dhe 30 minuta për 25 raste të dhunës në familje.

Tabela nr. 1 më poshtë tregon të gjithë koston e përlogaritur për gjyqtarët kur merren me rastet e dhunës në familje bazuar në një studim tre-mujor.

Tabela 1: Kosto e përlogaritur për një gjyqtar për rastet e dhunës në familje

Kostot e llogaritura për një gjyqtar për rastet e dhunës në familje	Shuma	njësia
Rroga mujore e gjyqtarit	117,000	lek
Rroga e gjyqtarit për 3 muaj	351,000	lek/3 muaj
UM të lëshuara në tre muaj	25	raste
Koha e përdorur për të lëshuar 1 UM	7.3	orë
Koha e përdorur për të lëshuar 25 UM	182.5	orë
Orët e punës në ditë të gjyqtarit	8	orë
Ditët e punës mesatarisht në muaj për gjyqtarin	26	ditë
Orët e punës së gjyqtarit në një muaj	208	orë
Norma e pagesës për orë e gjyqtarit	563	lek
Kostoja për një Urdhër Mbrojtje (UM)	4,106	lek
Ditët e punës së gjyqtarit në 3 muaj	78	ditë/3 muaj
Orët e punës së gjyqtarit në 3 muaj	624	orë/3 muaj
Implikimet financiare për një gjyqtar / orë pune (182,5 orë në 3 muaj)	102,656	lek / 3 muaj
Rastet e UM, UMM dhe UMM-UM	25	Raste/3 muaj
Përqindja e UM të lëshuara nga Gjykata	29 %	raste/3 muaj
Përqindja për UMM të lëshuara nga Gjykata	71 %	raste/3 muaj
në 25 raste, urdhrat e mbrojtjes (UM)	7	raste/3 muaj
në 25 raste UMM janë	18	raste/3 muaj
Numri i UMM të kthyera në UM gjatë procesit gjyqësor	4	raste/3 muaj
Koha për të lëshuar një UM (Urdhër Mbrojtje)	52.9	orë/3 muaj
Koha për të lëshuar një UMM	129.6	orë/3 muaj
Kostot e UM në 3 muaj	29,770	lek/3 muaj
Kostot e UMM në 3 muaj	72,886	lek/3 muaj

Policia e Shtetit

Rastet e trajtuara të dhunës në familje, nga ky aktor janë raste tipike, të thjeshta dhe të komplikuar.

Analiza e të dhënave tregon se viktimat e dhunës në familje e raportojnë fillimisht dhunën tek Policia e Shtetit, sepse ato e konsiderojnë policinë e shtetit një institucion të rëndësishëm që mund të mbrojë jetën e tyre dhe të anëtarëve të tjerë të familjes. Viktimat e dhunës në familje mendojnë se vetëm policia e shtetit mund t'i mbrojë ato nga përshkallëzimi i dhunës, mund ta parandalojë këtë dhunë, dhe ta bëjë autorin përgjegjës, siç përcaktohet nga ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Për më tepër, duke e raportuar dhunën tek policia e shtetit, viktimat e DHF kanë një provë më të mirë në lidhje me kërkesën e tyre për një urdhër mbrojtje pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Intervistat me punonjësit e policisë kanë zbuluar informacion dhe të dhëna interesante.

Së pari, Komisarariatet e Policisë nuk kanë oficerë të caktuar që të punojnë me rastet e dhunës në familje, në zonat e tyre të përgjegjësisë. Ata punojnë me parandalimin e krimit; megjithatë detyrat e punonjësit të policisë për adresimin e rasteve të dhunës në familje janë të përcaktuara shumë mirë nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (shtojca IV).

Së dyti, bazuar në intervistat me punonjësit e policisë dhuna në familje ndodh shpesh ndërmjet çifteve në prag të divorcit, si dhe ndërmjet ish-bashkëshortëve. Dhuna fizike është forma më e përhapur e dhunës në familje, megjithatë, kanë përhapje të konsiderueshme edhe dhuna psikologjike dhe social-ekonomike.

Së treti, një nga hapat që punonjësi i policisë ndjek për një rast të komplikuar të dhunës në familje është shoqërimi i viktimës së dhunës në strehëza, për të cilin shpenzon 1 orë e 50 minuta. Në rastin kur viktimja raporton në polici dhe është e shoqëruar me fëmijë minorenë, koha e shpenzuar është mesatarisht 3 orë e 20 minuta. Në mënyrë që të përgatisë kërkesën për gjykatën, një punonjës policie shpenzon mesatarisht 41 minuta për një rast të thjeshtë të dhunës në familje, 58 minuta për një rast tipik të DHF dhe 1 orë e 22 minuta për një rast të komplikuar të DHF. Një punonjësi të policisë i nevojitet rreth 2 orë e 52 minuta për të kompletuar të gjithë dokumentacionin për gjykatën, e kërkuar nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Së katërti, në përcaktimin e kohës që një oficeri policie i nevojitet për t’u angazhuar me një rast të dhunës në familje duhet të merret parasysh lloji i rastit të dhunës në familje, të cilat janë raste tipike, të thjeshta dhe të komplikuar (shtojca I). Rastet e komplikuar të dhunës në familje përbëjnë 50 % të të gjitha rasteve. Për një rast të komplikuar të dhunës në familje, një punonjës policie shpenzon mesatarisht 9 orë e 30 minuta. Mesatarisht, një punonjës policie shpenzon 9 orë e 12 minuta për një rast të dhunës në familje (bazuar në 19 raste në një periudhë tre mujore).

Tabela Nr. 2 më poshtë, tregon të gjitha kostot e përlogaritura për punonjësit e policisë në hapat e mëposhtme për të adresuar një rast dhune në familje, bazuar në një studim tre mujor.

Tabela 2: Kostot e përlogaritura për punonjësit e policisë që i përgjigjen dhunës në familje

Kostot e përlogaritura për punonjësit e policisë që i përgjigjen dhunës në familje	shuma	njësia
Rroga mujore e oficerit të policisë	51,380	lek/muaj
Rroga e punonjësit të policisë për tre muaj	154,140	lek/3 muaj
Raste mesatare për dhunën në familje në 3 muaj, në katër rrethe	5	raste/3 muaj
Koha që një rast i dhunës në familje i merr një punonjësi të policisë	9.2	orë
Orët e punës së punonjësit të policisë / ditë	8	orë
Orët e punës së punonjësit të policisë / muaj	208	ore
Rroga mesatare e punonjësit të policisë / orë	247	lek/ orë
Kosto e oficerit të policisë për një rast të vetëm të trajtimit të dhunës në familje (kosto mesatare)	2,273	lek
Koha që një punonjës policie i kushton rasteve / 3 muaj	624	orë /3 muaj
Koha e përdorur mesatarisht në 5 rastet e dhunës në familje për 3 muaj	46	orë /3 muaj
Implikimet financiare mesatare të oficerit të policisë në rastet e dhunës në familje në 3 muaj	11,363	lek/3 muaj
Kosto totale e të gjitha rasteve të dhunës në familje (19) për oficerët e policisë (në 3 muaj në 4 rrethe).	43,179	lek
Hapat e ndjekur nga oficerët e policisë për rastet e dhunës në familje		
Raste tipike të dhunës në familje (28% e 5 rasteve mesatare)	1.4	Rast tipik
Koha që një punonjës policie i kushton një rasti tipik	4.3	orë
Kostoja mesatare për një rast tipik të dhunës në familje	1,070	lek
Koha që një punonjës policie u kushton 1,4 rasteve	6.1	orë/3 muaj
Kostoja mesatare e rasteve tipike në 3 muaj	1,499	lek/3 muaj

Rastet e komplikuar të dhunës në familje (50% të 5 rasteve mesatare)	2.5	Rast i komplikuar
Koha që një punonjës policie i kushton një rasti të komplikuar të dhunës në familje	9.5	orë
<i>Kostoja mesatare për një rast të komplikuar të dhunës në familje</i>	<i>2,347</i>	<i>lek</i>
Koha që një punonjës policie i kushton 2,5 rasteve	23.8	orë
Kosto mesatare e rasteve të komplikuar në 3 muaj	5,867	lek/3 muaj
Rast i thjeshtë i dhunës në familje (22% të 5 rasteve mesatare)	1.1	Rast i thjeshtë
Koha që një punonjës policie i kushton një rasti të thjeshtë të dhunës në familje	2.5	orë
<i>Kostoja mesatare për një rast të thjeshtë të dhunës në familje</i>	<i>618</i>	<i>lek</i>
Koha që një punonjës policie i kushton 1,1 rasti	2.8	orë
Kostoja mesatare e rasteve të thjeshtë në 3 muaj	679	lek/3 muaj

Prokuroria e rrethit

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i jep prokurorisë së rrethit të drejtën që të kërkojë një Urdhër Mbrojtje. Gjykimi që zhvillohet mbi bazën e kërkesës së prokurorit nuk mund të ndërpritet edhe nëse palët heqin dorë nga ankesa e tyre. Gjatë studimit tre mujor nuk ishte dorëzuar ndonjë kërkesë për Urdhër Mbrojtje në gjykatë nga prokuroria e rrethit, në të katër rrethet e përfshira në studim.

Viktimat e dhunës në familje

Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” u siguron viktimave të Dhunës në Familje (DHF) të drejtën e

aksesit në drejtësi, për të kërkuar një UMM ose një UM. Ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” parashikon që në hartimin e kërkesës drejtuar gjykatës, viktimat mund të asistohen nga një avokat pa pagesë. Viktimat gjithashtu, janë të përjashtuara nga taksat që aplikohen nga gjykata dhe zyra e përmbarimit. Megjithatë, analiza e pyetësorëve tregon që viktimat e DHF harxhojnë një kohë të konsiderueshme dhe më përpara, që nga momenti që ato raportojnë dhunën, deri në momentin që zbatohet UM (Urdhri i Mbrojtjes) nga ana e autoriteteve shtetërore (shtojca I).

Viktimat e DHF shpenzojnë shumicën e kohë së tyre, 5 orë e 15 minuta, për të marrë vendimin e gjykatës. Viktimat e DHF presin mesatarisht 2 orë e 30 minuta që të fillojë seanca e shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e rrethit gjyqësor. Viktimës së DHF do t'i duhet rreth 1 orë e 45 minuta për të patur akses në një komisarjat policie për të raportuar dhunën. Megjithatë kjo kohë është më e paktë për ata që jetojnë në rrethet e Tiranës dhe Durrësit, krahasuar kjo, me ata që jetojnë në rrethet e Kukësit e Korçës. Koha mesatare totale që një viktime të DHF i nevojitet të raportojë dhe të marrë një UM është 10 orë e 21 minuta. Megjithatë, ka një mospërputhje ndërmjet rretheve të Tiranës e Durrësit dhe atyre të Kukësit e Korçës. Ndërsa në rrethet e Tiranës dhe të Durrësit viktimës i duhet më pak kohë, në rrethet e Kukësit dhe të Korçës u nevojitet katër herë më shumë.

Përveç kësaj, viktimat e DHF duhet të udhëtojnë, ndërsa shkon për të raportuar këtë dhunë, duke patur kështu kosto administrative dhe kosto për kujdesin ndaj fëmijës. Kosto mesatare e udhëtimit është 400 lek, kosto e kujdesit për fëmijën është 100 lek dhe kostot administrative rreth 200 lek. Gjithashtu, viktimat e DHF humbet rreth 500 lek, që është e ardhura mesatare për ditë pune që këto viktimat nuk do ta marrin për atë ditë.

6. Përfundime e sugjerime

Në realitet, kostot e dhunës në familje janë të shumta. Zhvillimi social-ekonomik i vendit kufizohet për aq kohë sa do të ekzistojë dhuna në familje. Studime të njëjta tregojnë se e gjithë shoqëria paguan kostot për shkak të moszgjidhjes së këtij fenomeni social. Sa më shpejt politikë-bërësit shqiptarë të dalin me politika dhe programe efektive që t'i japin fund dhunës në familje në Shqipëri, aq më shpejt Shqipëria do të reduktojë koston ekonomike të dhunës në familje, kështu që shoqëria do të përfitojë në terma afat-gjatë.

Forca e këtij studimi është përdorimi dhe rezultatet e tij. Kostot mund të përdoren si kontribute në studimet, të cilat kanë si synim të kuptojnë dhe të parandalojnë dhunën në familje. Kjo qasje dhe metodologji mund të aplikohet ndaj çdo komuniteti, në çdo vend, për çdo lloj forme të dhunës në familje. Politikë-bërësit mund të shqyrtojnë koston e hapave dhe të veprimeve të ndryshme për të adresuar dhunën në familje, si dhe të mund të zgjidhen ato çështje që i maksimalizojnë kursimet që lidhen me koston e zbatimit të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Dobësia kryesore e kësaj qasjeje dhe metodologjie është fakti se, sa e komplikuar është matja në mënyrë të saktë e kostove që lidhen me DHF. Kjo qasje përfshin kostot dhe kohën e përlllogaritur për personelin e tre institucioneve kryesore (Policia e Shtetit, Prokuroria e Rrethit, Gjykatat e Rrethit Gjyqësor si dhe të viktimave të DHF) në adresimin e DHF. Megjithatë, studimi nuk shkon në detaje të mëtejshme për të mbuluar koston komplekse, për shembull përlllogaritjet koha dhe kostoja e punonjësit të policisë, i cili e shoqëron viktimën për në Qendrën e Pritjes, por studimi nuk përlllogarit koston e transportit, amortizimin e makinës dhe karburantin që harxhohet. Vështirësia është tek gjetja e të dhënave të sakta dhe të detajuara.

Mungesa e fondeve të mjaftueshme për Policinë e Shtetit, Prokuroritë e Rretheve dhe për Gjykatat e Rretheve gjyqësore ndikon në përgjigjen e këtyre institucioneve ndaj DHF duke e vonuar këtë përgjigje. Për shembull, mungesa e fondeve për kompjuterë personale çon në vonesa në përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar dhe të kërkesë-padisë për në gjykatë.

- Ky studim dhe gjetje të tjera, duhet që të përdoren nga ana e autoriteteve shtetërore si manual ndihmës në përlogaritjen e kostove;
- Përmirësimi i infrastrukturës (komunikimi telefonik, transporti, hapësira zyre, etj.) për institucionet shtetërore përgjegjëse në zgjidhjen e DHF, të tilla si Policia e Shtetit, Gjykatat e rretheve gjyqësore si dhe Prokuroritë e Rretheve, do të ndihmojë në rritjen e performancës dhe të rendimentit të personelit;
- Nevojitet trajnim i vazhdueshëm mbi zbatimin e një përgjigjeje të koordinuar ndaj DHF dhe në një linjë me kërkesat e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” për gjyqtarët, prokurorët dhe oficerët e policisë, në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe rendimenti i tyre;
- Përmirësimi i ndihmës dhe i shërbimeve ligjore do të shkurtojë kohën që u nevojitet gjyqtarëve për të lëshuar një UM, duke patur kështu, më pak kosto financiare për gjykatat e rretheve gjyqësore;
- Duke zhvilluar një bashkëpunim më të mirë dhe më efikas ndërmjet gjykatave të rretheve gjyqësore, stacioneve të policisë, prokurorisë, shërbimeve ligjore falas, shërbimeve sociale, qendrave të pritjes, klinikave të kujdesit shëndetësor dhe me organizatat jo-fitimprurëse, do të ndihmonte për një menaxhim më të mirë të rasteve të DHF, si dhe do të shkurtohej

koha e përgjigjes nga ana e shërbimeve shtetërore dhe jo-shtetërore për viktimat e DHF. Kërkohet një bashkëpunim më i mirë për të përmirësuar efektivitetin e mekanizmit referues të DHF, që si rezultat do të sillte shkurtimin e kostos së menaxhimit të rasteve të DHF;

- Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të ngrenë strukturat lokale për të parandaluar dhe zgjidhur DHF, të sigurojnë të gjitha shërbimet që lidhen me DHF, duke përfshirë këtu linja pa pagesë që kanë për qëllim të lehtësojnë aksesin e viktimave ndaj këtyre shërbimeve, në më pak kohë dhe me një kosto më të ulët;
- Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të ngrenë një sistem të strukturuar të adresave të qytetarëve të tyre, sepse adresat e parregullta të palëve të përfshira në gjyqet e rasteve të DHF e zgjasin dhe e lënë në pritje gjyqin;
- Rritja e ndërgjegjësimimit në lidhje me fenomenin e DHF është shumë e rëndësishme, sepse ndihmon njerëzit që të kuptojnë më mirë se si të parandalojnë dhe të zgjidhin DHF, si të kuptojnë mekanizmin dhe kërkesat ligjore dhe si të mbrohen nga DHF;
- Sigurimi i mbështetjes psiko-sociale për anëtarët e abuzuar të familjes është i nevojshëm përpara se viktimat të vendosë ta dërgojë çështjen në gjykatë për të marrë një UM (Urdhër Mbrojtje).
- Siç u nënvizua, studimi është kryer në një numër të kufizuar rrethesh (në katër prej tyre). Në mënyrë që të sigurohet një tablo e përgjithshme ky studim duhet që të kryhet në të 12 qarqet e Shqipërisë.

Bibliografi

Tanis Day, PhD, Katherine McKenna, PhD, Audra Bowlus, PhD. “Kostot Ekonomike të Dhunës ndaj Grave”. Universiteti i Western Ontario, Canada. 2005.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. “Raport Monitorimi mbi zbatimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, 2010.

INSTAT. “Studim mbi dhunën në familje në Shqipëri”. 2009.

Vetten, L., Budlender, D. & Schneider, V. “Çmimi i mbrojtjes: Matja e kostonë së zbatimit të Aktit mbi dhunën në familje (Akti nr. 116 i vitit 1998)”. CSVR Gender Programme, Policy Brief Nr. 02, tetor 2005.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale, dhe Shanseve të Barabarta. Drejtoria e Shanseve të Barabarta dhe e Politikave të Familjes. <http://www.mpcs.gov.al/dpshb/en>, i kontrolluar së fundi në qershor 2011.

Shtojca I:

Tabelat Sqaruese

1 Koha e përdorur nga një gjykatës gjatë procesit të shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Koha e përdorur nga një gjykatës		KUKES	KORCA	TIRANA	DURRES	Mesatarisht (orë)
Numri i UM të lëshuar gjatë periudhës 3 mujore të studimit		3	23	43	32	
Hapat e ndjekur nga një gjykatës për të lëshuar një UM						
a	Koha për të lexuar / për t'u familiarizuar me dokumentet e rastit	0.28	0.28	0.47	0.44	0.37
b	Koha për të verifikuar palët në proces	0.11	0.21	0.17	0.17	0.17
c	Prezantimi i gjykatësit	0.08	0.08	0.14	0.17	0.12
d	Koha për të dëgjuar të dyja palët	1.33	0.94	1.33	2	1.40
e	Koha për të dëgjuar dëshmitarët	0.83	0.31	0.44	0.36	0.49
f	Koha për të administruar provat	0.25	0.25	0.17	0.2	0.22
g	Koha për të shpjeguar ndonjë çështje që lidhet me UM (Urdhër Mbrojtje)	0.17		0.17	0.22	0.19
h	Koha për të lëshuar një UMM	0.67	1.67	1.17	1.17	1.17
i	Koha për të verifikuar një UMM	0.25	1.17	1	1.83	1.06
j	Koha për të referuar viktimën e DHF tek shërbimet në dispozicion	0.25	2			1.13

SHTOJCA 1.

k	Koha për të përgatitur dhe arsyetuar vendimin e gjyqit.	1	0.33	1.5	2.17	1.25
l	Koha për të dëgjuar psikologun,	0.42		0.36	0.59	0.46
m	Koha për të dëgjuar përkthyesin					
n	Koha për të dëgjuar padinë e prokurorit	0.08				0.08
o						
p						
Totali i kohës i përdorur për të gjitha hapat		5.72	7.24	6.92	9.32	7.30
Përqindja për UM të lëshuara nga Gjykata		65.0%	7.0%	33.0%	12.0%	29%
Përqindja për UMM të lëshuara nga Gjykata		35.0%	93.0%	67.0%	88.0%	71%
Përqindja e UMM të kthyera në UM gjatë gjyqit		7.0%		57.0%	17.0%	20%
Për të gjitha rastet e përmendura më sipër seancat gjyqësore do të zgjaten nga faktorët e mëposhtëm:						58%
Autori i veprës e mohon dhunën e përdorur		46.0%	17.0%	13.0%		15%
Adresa të pasakta që autori i veprës jep në gjyq (gjatë procesit gjyqësor)		20.0%	17.0%	3.0%	20.0%	15%
Prezenca e formave specifike të DHF		60.0%	34.0%	7.0%	13.0%	29%
Për të gjitha rastet e përmendura më sipër seancat gjyqësore do të shkurtohen nga faktorët e mëposhtëm:						135%
Nëse jepen adresa korrekte nga të dyja palët		30.0%	8.0%	70.0%	80.0%	47%
Prezenca në procesin gjyqësor të të dyja palëve		50.0%	8.0%	57.0%	83.0%	50%

Provat i bashkëngjiten kërkesës (padisë)	40.0%	8.0%	13.0%	23.0%	21%
Autori i veprës e pranon fajësinë (përdorimin e dhunës)	40.0%	8.0%	23.0%	0.0%	18%
Zgjatja në rastet e ndryshimit të një UMM në UM	1				1.00
Perqindja e kërkesave për kthimin e UMM në UM	23.0%		33.0%	83.0%	35%

2 Koha e përdorur nga një oficer policie për të zgjidhur një rast të dhunës në familje

Hapat që ndiqen nga oficerët e policisë për zgjidhjen e një rasti të dhunës në familje (DHF)	Mesatarisht (orë)	Mesatarisht (minuta)	Mesatarisht (%)
Lajmërimi i palëve dhe shpjegimi mbi lajmërimin	0.37	22	
Shpërndarja e kopjove mbi lajmërimin	0.24	14	
Informimi i viktimave mbi aksesin në qendrat e pritjes	0.29	17	
Shoqërimi i viktimave të dhunës në familje për në qendrat e pritjes	2.19	131	
Informimi i viktimës së DHF në lidhje me shërbimet shëndetësore	0.44	26	
Shoqërimi i viktimave të DHF në klinikat mjekësore	1.36	82	
Informimi i viktimave të DHF në lidhje me shërbimet këshilluese	0.37	22	
Ekzekutimi i UM (sa shpesh ndodh i shprehur në %)			90.0%
Mbledhja e provave, pyetja e dëshmitarëve	1.25	75	
Hetimi i thyerjes/ i moszbatimit të UM (sa shpesh ndodh i shprehur në %)			92.5%
Plotësimi i dokumentacionit / dosjes	2.86	172	

SHTOJCA 1.

Totali	9.22	553	
Rast tipik i dhunës në familje			
Familiarizimi me rastin / rrethanat	1.27	76	
Kontakti i parë me autorin e veprës	1.90	114	
Prezantimi i viktimës së DHF me të drejtat	0.30	18	
Përgatitja e kërkesës (kërkesë-padisë) për gjykatën	0.97	58	
Dërgimi i dokumentacionit në gjykatë	1.10	66	
Totali për një rast tipik të dhunës në familje	4.33	260	
Perqindja e një rasti tipik të dhunës në familje			28.5%
Një rast i komplikuar i dhunës në familje			
Ardhja e viktimës së bashku me fëmijët	3.33	200	
Biseda me autorin e veprës	2.18	131	
Biseda me viktimën	0.82	49	
Biseda me psikologun	0.60	36	
Shoqërimi i viktimës në qendrën pritëse	1.88	113	
Përgatitja e kërkesës (kërkesë-padisë) për gjykatën	1.36	82	
Totali për një rast të komplikuar të DHF	9.50	570	
Perqindja e një rasti të komplikuar të DHF			50.0%
Rast i thjeshtë i dhunës në familje			
Takimi me viktimën e DHF	0.98	59	
Takimi me autorin e veprës	0.88	53	
Përgatitja e kërkesës (kërkesë-padisë) për gjykatën	0.68	41	
Totali i një rasti të thjeshtë të dhunës në familje	2.53	152	
Përqindja e një rasti të thjeshtë të DHF			21.5%

3 Koha dhe ndikimi i kostos tek viktimat e dhunës në familje

Hapat e ndërmarrë nga një viktimë e dhunës në familje	Mesatarisht	Njesia
Shpenzime udhëtimi	408	lek
Kohë e harxhuar në gjykatë	2.47	orë
Para të humbura për shkak të mungesës në punë	500	lek
Kostot që ndodhin për kujdesin ndaj fëmijëve kur prindërit nuk janë prezent	91	lek
Shpenzime për fotokopjime	200	lek
Kostot administrative		
Koha që nevojitet për të paraqitur kërkesën (padinë)	1.02	orë
Koha që nevojitet për të marrë një UM	5.28	orë
Koha që nevojitet për të shkuar në rajonin e policisë	1.68	orë
Koha që nevojitet për të përgatitur rastin	0.50	orë
Koha për të sqaruar rastin (nëse është e nevojshme)	0.25	orë
Vizita tek një mjek	0.43	orë
Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor		
Biseda me një avokat		
Totali i kohës	10.35	orë
Totali në lek	553	lek

Shtojca II:

Pyetësorët e studimit (gjyqtarë, prokurorë, oficerë policie dhe viktima të DHF)

1. Llogaritja e koston së ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Pyetësor intervistimi për Gjyqtarët

Faleminderit për kohën që ju po harxhoni për të biseduar me mua. Unë jam një studiues i QNL (Qendra për Nisma Ligjore Qytetare).

Ne po e kryejmë këtë studim për të zbuluar se sa është kostoja e zbatimit të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ne shpresojmë se ky informacion mund të përdoret për të vlerësuar buxhetin që gjykatat, prokuroritë dhe stacionet e policisë kanë nevojë për punën e tyre. Meqë ky studim është mbi ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, unë do të dëshiroja që ju të fokusoheni vetëm tek zbatimi i këtij ligji në përgjigjet tuaja.

Data e intervistës:	Koha e fillimit:
Gjykata:	Koha e mbarimit:
	Gjyqtari nr. (ju lutem qarkoni) 1 2
Emri: [duke siguruar që do të mbetet konfidencial]	
Pozicioni:	
Nr i viteve të punës në gjykatë:	
Numri i viteve në të cilët jeni marrë me trajtimin e rasteve të DHF dhe lëshimin e UM?	
(Afërsisht) totali [pra nuk bëhet fjalë 'për muaj'] i Urdhrave të Mbrojtjes me të cilët jeni marrë në tre muajt e fundit.	
Shkalla e pagës për këtë pozicion bazuar në një shkallë të caktuar page	

Tani do të dëshiroja t'ju drejtoja ju disa pyetje në lidhje me llojet e rasteve të dhunës në familje që ju trajtoni në zbatim të ligjit "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

1. Mund të përshkruani një rast tipik në të cilin një viktimë bën kërkesë për një UM (d.m.th. çfarë lloj abuzimi ndodh dhe cila është natyra e lehtësimit që kërkohet)?

1.1 Tani do të dëshiroja t'ju drejtoja disa pyetje në mënyrë të veçantë në lidhje me këtë rast tipik.

Mund ta fillojmë me shpjegimin mbi të gjitha hapat që ju ndiqni gjatë trajtimit të një rasti tipik që ka aplikuar për një Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje/Urdhër Mbrojtje, pra atë lloj rasti që ju ndeshni shpesh në gjykatë? Ndërsa ne do të kalojmë nëpër çdo hap të ndjekur, unë do të dëshiroja gjithashtu që të na tregonit se sa kohë ju harxhoni zakonisht për secilin hap.

SHTOJCA 2.

Hapat e përmendur nga gjyqtari	Koha mesatare për secilin hap që ndërmerret	% e përafërt e rasteve në të cilat ky hap është ndërmarrë.

- a. A harxhoni kohë përpara seancës gjyqësore duke lexuar/duke u njohur me dokumentet?
- b. Koha që harxhoni për të verifikuar palët në seancë;
- c. Koha që harxhohet në seancë për prezantimin e gjyqtarit dhe sekretarit të gjyqit;
- d. Koha që harxhohet për të dëgjuar palët;
- e. Koha që harxhohet për të dëgjuar dëshmitarë nëse ka të tillë;
- f. Koha që harxhohet për të administruar provat;
- g. Koha që harxhohet për të mbajtur shënim mbi gjetje ose mbi çfarëdo problemi?
- h. Koha që harxhohet për të nxjerrë një urdhër mbrojtje të ndërmjetëm;
- i. Koha që harxhohet për të verifikuar urdhrin e ndërmjetëm të mbrojtjes;
- j. Koha që i referoheni gruas së dhunuar;
- k. Koha që duhet për të përgatitur dhe arsyetuar vendimin gjyqësor;
- l. Koha që ju duhet për të dëgjuar psikologun nëse kjo aplikohet
- m. Koha që ju duhet për të dëgjuar përkthyesin nëse kjo aplikohet;
- n. Në çfarë proporcioni (përqindje) rastesh nevojiten përkthyesit?
- o. Në cilat pjesë të procesit gjyqësor nevojiten përkthyesit?
- p. Të tjera_____Ju lutem specifikojeni

2. Sa përqind të rasteve përfshijnë aplikimin vetëm për UM ose vetëm për UMM dhe sa është përqindja e rasteve ku përfshihen aplikimet për të dyja urdhrat? UM _____%
UMM _____% UM&UMM _____%
3. Çfarë (faktorësh/ngjarjesh/gjërash?) mund të sjellin zgjatjen në kohë të procesit gjyqësor?

Faktorët	PO ose JO	% e rasteve në të cilët kjo zgjatje ndodh
• Autori e mohon dhunën;		
• Autori nuk ka marrë njoftim formal për gjyqin për shkak të adresës së gabuar;		
• Forma specifike të dhunës të tilla si dhunë ekonomike, psikologjike dhe seksuale, pjesëmarrje të fëmijëve në skenat e dhunës, etj.		
• Të tjera _____ Ju lutem specifikojeni		

4. Çfarë (faktorësh/ngjarje/gjëra?) mund të ndihmojnë në uljen e kohës së procesit të aplikimit të Urdhrave të përkohshëm?

Faktorët	PO ose JO	Sa shpesh ndeshen këta faktorë, e shprehur kjo në %, në lidhje me pyetjen e mëparshme?
-adresa korrekte e palëve;		
-prezenca e palëve në proces;		
-prova të bashkëngjitura kërkesës (për UM, UMM ose UM&UMM);		
-autori e pranon ushtrimin e dhunës;		
Të tjera _____ Ju lutem specifikojeni		

- 4.1 Në çfarë proporcioni të rasteve tuaja tipike palët kthehen për seancën finale?
- 4.2 Në çfarë proporcioni të rasteve arrijnë që të vijnë të dyja palët në seancën finale?
- 5. Në sa përqind të urdhrave të mbrojtjes të lëshuara nga ju ka kërkesa për ndryshimin, lënien mënjane apo zgjatjen e këtij urdhri?
- 5.1 [Nëse PO, mund të na i përshkruani të gjitha hapat që ju ndiqni për të trajtuar sërish kërkesën për ndryshim /lenie mënjane/zgjatje të urdhrit të lëshuar? Sa kohë harxhoni ju për secilin hap?

Sa kohë harxhoni ju për të dëgjuar provat nga të dyja palët?

Sa kohë harxhoni ju për të dëgjuar provat nga dëshmitarë të tjerë?

Sa kohë harxhoni ju për të mbajtur shënim mbi gjetje apo çfarëdolloj problemi?

Sa kohë ju duhet ju për të dëgjuar përkthyesit? Në çfarë proporcioni/përqindje rastesh nevojiten përkthyesit?

- 6. A ka gjëra/veprime të tjera që lidhen me ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” që ju i kryeni në mënyrë tipike për të cilat unë nuk ju kam drejtuar pyetje? Cilat janë ato? Sa kohë ju duhet për të kryer secilin nga këto veprime?
-

2. Llogaritja e kostos së ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Pyetësor intervistimi për oficerët e policisë

Faleminderit për kohën që ju po harxhoni për të biseduar me mua. Unë jam një studiues i QNL (Qendra për Nisma Ligjore Qytetare).

Ne po e kryejmë këtë studim për të zbuluar se sa është kostoja e zbatimit të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ne shpresojmë se ky informacion mund të përdoret për të vlerësuar buxhetin që gjykatat, prokuroritë dhe stacionet e policisë kanë nevojë për punën e tyre. Meqë ky studim është mbi ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, unë do të dëshiroja që ju të fokusoheni vetëm tek zbatimi i këtij ligji në përgjigjet tuaja.

Data e intervistës:	Koha e fillimit të intervistës:
Stacioni i policisë:	Koha e mbarimit të intervistës:
	Oficeri i policisë nr. (ju lutem qarkoni) 1 2 3
Emri:	
Pozicioni: Pjesëtar i Departamentit të Policisë së Hetimit të Krimin apo i Departamentit të Sigurisë dhe Rendit Publik	
Nr. i viteve që punon në Policinë e Shtetit:	
Shkalla e pagës për këtë pozicion bazuar në shkallën e pagave:	
Sa orë punoni zakonisht çdo ditë?	

1a. Në punën tuaj merreni vetëm me dhunën në familje

PO JO

1b. Nëse jo, në çfarë çështje të tjera fokusoheni ju?

1c. A ju ka caktuar stacioni juaj i policisë që të punoni vetëm me dhunën në familje? (d.m.th..me dhunën në familje merren vetëm punonjës policie të caktuar apo kushdo nga punonjësit e policisë merren me DHF?)

Tani do të dëshiroja t'ju drejtoja disa pyetje në lidhje me llojet e rasteve të dhunës në familje që ju trajtoni në zbatim të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

2. Cili është lloji i rastit të dhunës në familje që përfshin aplikimin për një Urdhër Mbrojtje me të cilin merreni ju në shumicën e rasteve? A mund ta përshkruani ju këtë rast TIPIK (d.m.th. çfarë ndodh, çfarë lloj ndihme kërkohet nga policia? Si përfshihet punonjësi i policisë – a ju thërresin ju që të shkoni atje/ apo ato që ankohen vijnë në stacion? Nga 10 raste në sa prej tyre ankuesit vijnë dhe ankohen në stacionin e policisë?)

2.1. Cili quhet një rast i komplikuar? Sa shpesh ndesheni me raste të komplikua (nëse është e mundur vlerësimin bëjeni bazuar në një numër prej 10 rastesh)?

2.2. Cili është një rast i thjeshtë? Sa shpesh ndesheni me këto raste të thjeshta (Nëse është e mundur vlerësimin bëjeni bazuar në një numër prej 10 rastesh)?

3. Duke menduar rreth këtij rasti tipik, pra, rreth rastit që ju ndesheni më shpesh, ju lutem mund të më shpjegoni mua të gjitha hapat që ju ndiqni për të trajtuar këtë rast?. Ndërsa ju më shpjegoni çdo hap që kryeni, unë gjithashtu do të dëshiroja që ju të më tregoni edhe sa kohë harxhoni për secilin hap të kryer.

RAST TIPIK

Hapi	Koha që ju merr

RASTI I KOMPLIKUAR

Hapi	Faktori Komplikues	Koha që ju merr	Nga 10 raste, sa shpesh e kryeni këtë/sa shpesh ndodh kjo?

RAST I THJESHTË

Hapi	Faktori Komplikues	Koha që ju merr	Nga 10 raste, sa shpesh e kryeni këtë/sa shpesh ndodh kjo?

Veprimet e mundshme të punonjësit të policisë:

- Lajmërimi dhe shpjegimi i lajmërimit
- Fotokopjimi i lajmërimeve?
- Informimi i grave mbi Qendrat Pritëse
- Transportimi i grave në Qendrën e Pritjes? [Nëse ata merren ndonjëherë me transportimin e grave për në Qendrën e Pritjes në sa përqind të rasteve përfshihen ata në këtë transport?]
- Informimi i grave mbi shëndetin dhe shërbimet publike?
- Shoqërimi i grave të dhunuara në institucionet e shëndetit/ mjekësore? [Nëse ata merren ndonjëherë me shoqërimin e grave të dhunuara për në institucionet e shëndetit/ mjekësor në sa përqind të rasteve përfshihen ata në këtë shoqërim?]
- Informimi i grave të dhunuara mbi shërbimet e këshillimit?
- Dërgimi i Urdhrave të Mbrojtjes? [Ndërsa ata i dërgojnë ndonjëherë Urdhrat e Mbrojtjes në sa përqind të rasteve përfshihen në këtë proces?]

Kapja, ose ndalimi i abuzuesit/dhunuesit? [në sa përqind të rasteve veprojnë ata në këtë mënyrë?]

- Marrja e dëshmimeve të dëshmitarëve
- Hetimi i thyerjes së Urdhrave të Mbrojtjes
- Plotësimi i dokumentacionit

4. A ka gjëra/veprime të tjera që lidhen me ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” që ju i kryeni në mënyrë tipike për të cilat unë nuk ju kam drejtuar pyetje?

4.1. [Nëse po] Cilat janë këto gjëra/veprime? Sa kohë ju merr secila prej tyre?

Aktivitete/gjëra të tjera	Koha që ju merr	Nga 10 raste, sa shpesh e bëni ju këtë gjë/veprim? [Unë nuk jam i sigurtë për këtë pyetje, sepse këto gjëra/veprime të tjera mbase nuk lidhen me raste individuale p.sh. mund të jetë pjesëmarrja në mbledhje. Kështu që sa shpesh në muaj i kryeni këto gjëra/veprime.]
---------------------------	-----------------	---

5. Për çfarë burimesh keni nevojë që t’ju ndihmojnë ju në punën tuaj për zbatimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”? Çfarë do t’ju ndihmonte ju për të bërë punën tuaj në mënyrë më efektive?

Faleminderit për kohën tuaj. Mund t’ju kontaktoj përsëri nëse unë do të kisha ndonjë pyetje?

Vërejtjet e intervistuesve, duke përfshirë këtu çdo informacion shtesë që del nga intervistat:

3. Llogaritja e kostos së ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Pyetësor intervistimi për prokurorët

Hyrje

Faleminderit për kohën që ju po harxhoni për të biseduar me mua. Unë jam një studiues i QNL (Qendra për Nisma Ligjore Qytetare).

Ne po e kryejmë këtë studim për të zbuluar se sa është kostoja e sistemit të drejtësisë penale për zbatimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ne shpresojmë se ky informacion mund të përdoret për të vlerësuar buxhetin që gjykatat, prokuroritë dhe stacionet e policisë kanë nevojë për punën e tyre. Meqë ky studim është mbi ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, unë do të dëshiroja që ju të fokusoheni vetëm tek zbatimi i këtij ligji në përgjigjet tuaja.

Data e intervistës:	Koha e fillimit:
Zyra e Prokurorisë:	Koha e mbarimit:
	Prokurori nr. (ju lutem qarkoni) 1 2 3
Emri:	
Pozicioni:	
Numri i viteve që punoni për Zyrën e Prokurorisë:	
Shkalla e pagës për këtë pozicion bazuar në shkallën e pagave:	
Sa orë punoni zakonisht çdo ditë?	

Do të dëshiroja t’ju drejtoja disa pyetje në lidhje me llojet e rasteve të dhunës në familje që ju trajtoni në zbatim të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

1. Me çfarë lloji të rastit të dhunës në familje (fokusuar tek e drejta

e prokurorit si një subjekt legjitim për të dorëzuar kërkesën për Urdhër Mbrojtje në gjykatë.) merreni më shpesh? Mund të na e përshkruani këtë rast TIPIK (d.m.th. të na shpjegoni se çfarë ndodh)?

2. Ju lutem, shpjegoni të gjitha hapat që ju ndiqni për të dorëzuar një kërkesë për Urdhër Mbrojtje në gjykatë?

Sa kohë harxhoni ju për secilin hap?

RAST TIPIK

Hapi	Koha që ju merr

RASTI I KOMPLIKUAR

Hapi	Faktori Komplikues	Koha që ju merr	Nga 10 raste, sa shpesh e kryeni këtë/sa shpesh ndodh kjo?

RAST I THJESHTË

Hapi	Faktori Komplikues	Koha që ju merr	Nga 10 raste, sa shpesh e kryeni këtë/sa shpesh ndodh kjo?
------	-----------------------	--------------------	--

Veprimet e mundshme të Prokurorit

- Leximi i shënimeve dhe i dokumenteve
- takime me paditësen dhe me dëshmitarë të tjerë para gjyqit
“Paraqitja e kërkesës në gjyq”
- çdo gjë që del për ta dokumentuar më pas (pas dorëzimit të kërkesës në gjyq)

A ka veprime të tjera që kanë të bëjnë me ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” që ju e kryeni në mënyrë tipike, por që unë nuk ju pyeta?

[Nëse PO, Cilat janë këto gjëra/veprime? Sa kohë ju merr secila prej tyre?

Hapi	Faktori Komplikues	Koha që ju merr	Nga 10 raste, sa shpesh e kryeni këtë/sa shpesh ndodh kjo?
------	-----------------------	--------------------	--

3. Për çfarë burimesh keni nevojë që t’ju ndihmojnë ju në

punën tuaj për zbatimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”/Çfarë do t’ju ndihmonte ju për të bërë punën tuaj në mënyrë më efektive?

Faleminderit për kohën tuaj. Mund t’ju kontaktoj përsëri nëse unë do të kisha ndonjë pyetje ?

RAPORT 2.

Mbi koston e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij, në rrethet Vlorë dhe Korçë”

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi dhe metodologjia e studimit	63
2. Baza ligjore e studimit	70
3. Gjetjet e studimit	74
1. Kostoja e punës së Koordinatorit vendor	75
2. Kostoja e punës së gjykatës së rrethit gjyqësor	83
3. Kostoja e punës së strukturës së policisë	84
4. Kostoja e punës së përfaqësuesit të Drejtorisë Arsimore	84
5. Kostoja e punës së përfaqësuesit të Drejtorisë së Shëndetit Publik	87
6. Kostoja e punës së përfaqësuesit të Shërbimeve sociale pranë bashkisë	89
7. Kostoja e punës së punonjësit të Zyrës së përmbaramit ..	93
8. Kostoja e punës së punonjësit të prefekturës	97
9. Kostoja e punës së punonjësve të Zyrës së punësimit ..	98
10. Kostoja e punës së punonjësve të strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës	99
11. Kosto të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për shpenzimet e viktimës së dhunës	104
4. Përmbledhje e përfundimeve dhe sugjerime	106
Bibliografia	115
Aneks I	116
Aneks II	125

1. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është matja e kostos së zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave, (VKM) nr.334, datë 17.2.2011 *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”* (VKM e mekanizmit të referimit), për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në qytetet e Korçës, Kukësit dhe Vlorës. Ne synuam që në fund të studimit të arrinim në përgatitjen e ekzemplarëve, cilët do të shërbejnë në përlllogaritjen e shpenzimeve të nevojshme buxhetore, veçanërisht në buxhetet vendore. Natyrisht, mbështetja të këta ekzemplarë do të bëhet duke marrë parasysh kategorizimin, standardet e bashkive, si dhe situatën e dhunës në familje në çdonjërin prej tyre. Ndërkohë, janë një bazë e mirë ndihmëse për të nxjerrë përfundimet e duhura edhe në përlllogaritjet e parashikimet e buxhetit të Shtetit.

Gjatë punës për llogaritjet e kostos, studimi ka vënë në dukje edhe detyrat që kryejnë në praktikë aktorët e mekanizmit të referimit, duke na dhënë mundësinë që të nxjerrim edhe përfundimet mbi mbarëvajtjen e punës së tyre. Mendojmë se ky studim do të shërbejë si një model i dobishëm për sa vijon:

1. Për vlerësimin e punës hap pas hapi të të gjithë aktorëve që kryejnë veprimtaritë përkatëse në kuadrin e mekanizmit dhe përcaktimin imtësisht të detyrave në përshkrimin e tyre të punës.
2. Për analizën e bashkëveprimit midis aktorëve dhe vënien në dukje të problemeve në punën e gjithsecilit prej tyre.
3. Për ofrimin e modeleve të kostimit për pushtetin vendor, me qëllim kostimin dhe përgatitjen e buxheteve në bazë të

nevojave reale, në lidhje me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.

4. Për të nxjerrë detyrat, me qëllim lobimin për buxhetin gjinor.
5. Për forcimin e punës për të gjithë punonjësit socialë rajonalë, që do të ndjekin rastet e dhunës në familje.
6. Për të përgatitur manuale mbi përdorimin e kohës së punës, me qëllim që secili prej aktorëve të analizojë sesi e përdor ai kohën, sa i dobishëm është përdorimi i saj dhe sesi duhet të ketë më tepër efektshmëri.
7. Për përllogaritjen e kostove, me qëllim marrjen e masave pozitive për zbatimin e ligjit kundër dhunës në familje dhe të VKM-së së mekanizmit të referimit.

Metodikisht, studimi u përgatit nga grupi i punës, në përbërje të të cilit morën pjesë ekspertë ligjorë për çështje të adresimit të dhunës në marrëdhëniet familjare, ekspertë të barazisë gjinore dhe ekspertë për çështje ekonomike. Kjo ndërthurje në përzgjedhjen e ekspertëve lidhet me faktin se, për realizimin e studimit nevojitej njohja e legjislacionit kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, dhe, në mënyrë të veçantë, njohja e ligjit kundër dhunës në familje, njohja e akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, si dhe njohja e VKM-së së mekanizmit të referimit. Nga ana tjetër, nevojiteshin njohuri mbi fenomenin e dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe të kuptimit të kësaj forme dhune, si dhunë me bazë gjinore. Gjithashtu, krahas njohurive të mësipërme, grupi i ekspertizës duhet të kishte edhe njohuri për çështjet ekonomike, pasi ishin të nevojshme për të përfunduar të gjithë punën për përllogaritjen e kostos.

Puna filloi me *njohjen e mirë të të gjithë bazës ligjore*. Krahas akteve ligjore objekt kostimi, u vunë në dukje ndryshimet e fundit të ligjit kundër dhunës në familje¹, si dhe ndryshimet e Kodit

1 [Ligji nr.10329, datë 30.09.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'".](#)

Penal të RSh-së². Rileximi i legjislacionit ndihmoi në përgatitjen e të gjithë pyetësorëve, si dhe në përcaktimin e radhës së punës.

Përgatitja e pyetësorëve nga grupi i ekspertëve u bë duke mbajtur parasysh punën konkrete që kryen çdo aktor, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga VKM për mekanizmin e referimit, në frymën e kërkesave të ligjit kundër dhunës në familje.

Me qëllim testimin e draft pyetësorëve, grupi i ekspertëve zhvilloi një *intervistë pilot me aktorë përgjegjës* në zbatim të VKM-së. Bazuar në përfundimet e kësaj interviste, u rishikuan draft pyetësorët dhe u formuluan në formën përfundimtare.

Kështu, në Korçë dhe Vlorë janë intervistuar koordinatorët vendorë, përfaqësuesi i shërbimit social, përfaqësuesi i shëndetësisë, përfaqësuesi i zyrës së arsimit, përfaqësuesi i zyrës së punësimit, përfaqësuesi i prefekturës, përfaqësuesi i OJF-ve, punonjës të Strehëzës, përfaqësuesi i zyrës së përmbartimit, përfaqësuesi i Komunës. Të gjithë aktorëve të intervistuar u janë drejtuar pyetje në lidhje me kohën e shpenzuar për zbatimin e kompetencave të tyre që burojnë drejtpërdrejt nga VKM-ja, si dhe për kohën e shpenzuar për veprimtaritë e tjera në lidhje me veprimtarinë e bashkërenduar. Këto të fundit, ata i kryejnë në ndihmë të zbatimit të detyrave të përcaktuara nga aktet ligjore të sipërpërmendura, si: kohën e shpenzuar për punën menaxhuese e koordinuese; kohën e shpenzuar për bashkëpunimin me aktorë të tjerë; kohën e shpenzuar për raportime, informacione etj., për një adresim sa më efektiv të fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Në përfundim të procesit të intervistimit, *të dhënat e përfuara nga pyetësorët, u përpunuan nga ekspertët.*

Të dhënat e pyetësorëve, të përpunuara, shërbyen si bazë për *përgatitjen e raportit*. Variablat e përdorura për gjetjet e studimit

2 Ligji 23/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë'", të ndryshuar.

janë koha e shpenzuar për trajtimin e një rasti të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe paga e aktorëve përgjegjës, variable këto, që na ndihmuan për llogaritjen e kostos së mekanizmit të referimit.

Informacioni i marrë nga përgjigjet e pyetësorit, në mënyrë të veçantë ai mbi burimet e nevojshme për të rritur efektivitetin dhe nevojat e të mbijetuarave të dhunës, përbën një mbështetje të mirë për rekomandimet e studimit, të cilat do të përdoren si një platformë lobuese për organizatën dhe aktorë të tjerë në të ardhmen, me qëllim shërbime më të efektshme për rritjen e aksesit të të mbijetuarave, në sistemin e drejtësisë.

Gjatë intervistës *është respektuar etika dhe janë informuar aktorët* mbi projektin, qëllimin e studimit, mënyrën sesi do të shërbejë informacioni i marrë prej tyre për kostimin e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës, si dhe mënyrën sesi do të përdoren gjetjet dhe rekomandimet e studimit për të vlerësuar buxhetet dhe ndërhyrjet në to, me qëllim zbatimin e ligjit kundër dhunës në familje dhe VKM-së për mekanizmin e referimit.

Bazuar në përbërjen e mekanizmit të bashkërendimit dhe referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, u kryen intervistat e aktorëve përgjegjës, me qëllim kostimin e punës së tyre për menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Me qëllim saktësinë në informacionin e marrë, u janë drejtuar pyetje aktorëve në lidhje me numrin e orëve të punës në ditë dhe në lidhje me faktin nëse, përveç çështjeve të dhunës në familje, trajtojnë apo jo edhe çështje të tjera. Që në fillim të studimit, ne bëmë të qartë se aktorë të ndryshëm që bëjnë pjesë në mekanizmin e referimit nuk janë përgjegjës vetëm për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje, por edhe për trajtimin e

çështjeve të tjera. Kështu, punonjësit në komisaritet e Policisë ose në drejtoritë e Policisë në rrethe, koordinatorët vendorë, punonjësit e qendrave shëndetësore, trajtojnë në punën e tyre të përditshme jo vetëm çështje të dhunës në familje, por edhe fusha të tjera.

Gjatë punës qartësuam, gjithashtu, se çështjet që referonin aktorët kishin shkallë të ndryshme vështirësie. Kështu, në pyetësor janë përfshirë pyetje që lidhen me kohën e shpenzuar nga aktorët për trajtimin e një çështjeje *të lehtë, tipike dhe të ndërlikuar*. Në fakt, nuk arritëm të japim ndonjë përkufizim mbi kuptimin e tri kategorive të çështjeve, por aktorët e intervistuar u pyetën në lidhje me kuptimin se çfarë përbën për ta një çështje të lehtë, tipike apo e ndërlikuar. Gjatë kryerjes së intervistave doli se për disa nga aktorët e intervistuar një çështje tipike ishte një çështje e thjeshtë, prandaj u mbledhën të dhëna në lidhje me dy tipe çështjesh: *të thjeshta dhe të ndërlikuara*.

Më tej, për të krijuar një panoramë sa më të saktë për kohën e shpenzuar për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, aktorët e intervistuar u pyetën: sa çështje janë të thjeshta në 10 çështje të trajtuara? Sa çështje janë të ndërlikuara në 10 çështje të trajtuara? Përgjigjja e kësaj pyetjeje do të na ndihmonte për të llogaritur kohën dhe koston e shpenzuar nga aktorët e intervistuar, jo vetëm për një rast, por edhe në periudha më të gjata, veçanërisht njëmuajore ose njëvjeçare, mbështetur në llojin e çështjes dhe në numrin e çështjeve të trajtuara.

Të intervistuarit kanë përshkruar *hapat që ndjekin për trajtimin e një çështjeje të thjeshtë ose të ndërlikuar, si dhe kohën që shpenzojnë për çdo hap*. Gjithashtu, nga pyetësorët është marrë informacion në lidhje me detyrat e tjera që kryejnë aktorët e

mekanizmit, si dhe kohën e shpenzuar për zbatimin e tyre. Me qëllim matjen e plotë dhe të saktë të kohës së shpenzuar nga çdo aktor, të intervistuarit janë pyetur në lidhje me hapa të tjerë që ata kryejnë në zbatim të ligjit kundër dhunës në familje, si dhe të VKM-së për mekanizmin e referimit, për një periudhë mesatare prej një muaji.

Një pyetje me shumë rëndësi, e përfshirë në pyetësor, është ajo në lidhje me burimet materiale dhe njerëzore që u nevojiten aktorëve në zbatimin e ligjit kundër dhunës në familje, si dhe çfarë do t'i ndihmonte ata për të përmbushur detyrat e tyre me efektshmëri. Përmes përgjigjes së kësaj pyetjeje nga të intervistuarit, grupi i ekspertëve ka rikonfirmuar gjetjet dhe ka mundur të sigurojë informacion në lidhje me ndërhyrjet e nevojshme.

Gjithashtu, të gjithë aktorët kanë dhënë opinionin e tyre në lidhje me problematikat në zbatimin e Ligjit dhe të VKM-së, si dhe në lidhje me shkaqet që e rrisin ose e zvogëlojnë koston e punës së tyre.

Shtrirja e studimit në Korçë, Vlorë dhe Kukës krijoi mundësinë e analizave dhe gjetjeve krahasuese. Kështu, në raportin përfundimtar të këtij studimi, janë pasqyruar gjetjet që kanë rezultuar nga intervistat e kryera në Bashkinë Korçë dhe Vlorë, të analizuara në vështrim krahasues. Përmes procesit të intervistimit për aktorët përgjegjës në Korçë e Vlorë, jo vetëm u zbulua shkalla e veprimtarisë së mekanizmit të bashkërendimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje, por edhe u “fotografua” puna dhe efektshmëri e tij, përkatësisht, në të dy rrethet. Gjithashtu, u vunë në dukje diferenca në veprimtarinë dhe efektshmërinë e punës së mekanizmit në të dy rrethet.

Pengesat dhe deficitet metodologjike

Gjatë punës u ndeshëm edhe me disa pengesa e deficite metodologjike, për të cilat ne nuk i kishim marrë masat më parë. Natyrisht, duke i njohur këto pengesa, u përpoqëm t'i tejkalonim në mënyrë të tillë që të mos pengonin arritjen e përfundimeve të kostimit.

Së pari, në Bashkinë Kukës, nuk arritëm të masnim koston e mekanizmit të bashkërendimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje, për shkak se nuk ishte caktuar koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si një hallkë shumë e rëndësishme në zbatim të VKM-së për mekanizmin e referimit. Natyrisht, aktorët përgjegjës në mënyrë të veçantë kryenin një sërë detyrash, por jo në mënyrë të bashkërenduar, në kuadrin e ekipit teknik.

Së dyti, në përlllogaritjet që kryem, ne arritëm të njësonim vetëm kohën e punës për secilin prej aktorëve, por nuk mund të njësonim koston, nga njëra bashki në tjetrën. Prandaj, në raport mbajtëm parasysh se *ndryshimet në kohë dhe kosto nga njëra njësi në tjetrën* lidhen me disa shkaqe: *së pari*, me aktivitetin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje dhe forcimin e tij; *së dyti*, me ndërhyrjet përmes projekteve pilot në bashkitë objekt studimi, si nga organizata kombëtare, ashtu edhe ato ndërkombëtare; *së treti*, me përgjegjshmërinë e pushtetit vendor për të vendosur në axhendën dhe buxhetet e tyre çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare si çështje parësore. Natyrisht, nuk anashkalojmë edhe faktin se kjo veprimtari lëviz ndjeshëm me rritjen e ndërgjegjësimit dhe

përgjegjshmërisë së aktorëve përgjegjës, me rritjen e nivelit të bashkërendimit midis aktorëve, si dhe me rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të komunitetit, në mënyrë të veçantë grave dhe vajzave të dhunuara, për të adresuar dhunën.

Së treti, një pengesë tjetër u krijua në përlogaritjet e kohës së punës për veprimtari të tjera që kryenin aktorët, përveç veprimeve që kryenin për ndjekjen e një rasti dhune. Kjo pasi, këtë shpenzim kohe, aktorë të ndryshëm e kryenin në periudha të ndryshme, periudhë që ne e mesatarizuar në njësinë e kohës prej 1 muaji.

2. BAZA LIGJORE E STUDIMIT

Baza ligjore mbi të cilën u mbështet ky studim përbëhet nga dy akte kryesore: nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.334, datë 17.2.2011 *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”*, dhe nga ligji nr.9669, dt.18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar me ligjin nr.10329, datë 30.09.2010 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”*. Gjithashtu, është studiuar edhe raporti me ndryshimet e reja që u bënë gjatë këtij viti, në Kodin Penal të RSh³.

Është e qartë se VKM-ja e sipërpërmendur përmbush një nga qëllimet kryesore të ligjit *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, pra, garantimin e mbrojtjes me masa

3 Ligji 23/2012, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’*”, të ndryshuar.

të bashkërenduara administrative e gjyqësore të pjesëtarëve të familjes nga dhuna në marrëdhëniet familjare. Ky vendim ngriti për herë të parë një mekanizëm kombëtar për bashkërendimin e punës për referimin e rasteve të dhunës në familje, në nivelin vendor të bashkisë. Mekanizmi është ndërtuar mbi 3 struktura të rëndësishme: Komiteti drejtues, ekipet teknike ndërdisiplinore dhe koordinatori vendor. Në përbërje të këtyre strukturave përfaqësohen disa institucione të pushtetit qendror e vendor, që veprojnë pranë kësaj njësie vendore. Vendimi i Këshillit të Ministrave ka përcaktuar detyrat dhe procedurat që do të ndiqen nga këta aktorë jetëdhënës të mekanizmit, si dhe mënyrën e ndërhyrjes konkrete për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, në formë të bashkërenduar.

Në vijim, po paraqesim shkurtimisht disa nga hallkat kryesore të këtij mekanizmi⁴.

A. Komitetet drejtuese

Komiteti drejtues synon koordinimin dhe bashkërendimin e përpjekjeve të institucioneve përgjegjëse dhe strukturave të tjera, shtetërore dhe joqeveritare, në luftën kundër dhunës në familje, veçanërisht për mbrojtjen e mbështetjen e viktimave, si dhe vënien përpara përgjegjësisë të dhunuesve.

Komitetet drejtuese identifikojnë problemet, vlerësojnë punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, rekomandojnë masa për përmirësimin e veprimtarisë bashkërenduese për strukturat në nivel vendor, përfshihen në veprimtari ndërgjegjësuere nëpërmjet organizimit të trajnimeve të personelit dhe njohjes së qytetarëve me çështje të funksionimit të strukturave të krijuara për këtë qëllim.

4 Në mënyrë të plotë, shih VKM nr.334, datë 17.2.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij".

Komitetet drejtuese kryesohen nga kryetari i bashkisë dhe përbëhen nga:

- a) përfaqësuesi i strukturës së policisë,
- b) përfaqësuesi i Gjykatës së rrethit gjyqësor,
- c) përfaqësuesi i Prokurorisë së rrethit,
- ç) përfaqësuesi i Drejtorisë arsimore,
- d) përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik,
- dh) drejtuesi i strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë,
- e) përfaqësuesi i strukturës për shërbimet sociale në komunë,
- ë) përfaqësuesi i zyrës së Përmbarimit,
- f) përfaqësuesi i prefekturës,
- g) kryetarët e komunave që janë në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki,
- gj) përfaqësuesi i zyrës përkatëse të punësimit,
- h) drejtuesit e organizatave jofitimprurëse që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të dhunës në familje,
- i) drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë njësi të qeverisjes vendore ose në qarkun në juridiksionin e të cilit këto njësi janë,
- j) Përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare,
- k) drejtuesi i Dhomës së Avokatisë së rrethit.

B. Ekipet teknike ndërdisiplinore

Ekipet teknike ndërdisiplinore përbëhen nga përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuara në Komitetin Drejtues, përfaqësues të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve, nëpunës vendorë të barazisë gjinore, si dhe profesionistë të lirë, avokatë, psikologë etj.

Ekipet teknike ndërdisiplinore ndjekin dhe menaxhojnë rastet konkrete të paraqitura pranë tyre, duke siguruar lidhjen e viktimave me shërbimet e përshtatshme.

C. Koordinator i vendor

Pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësues i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore. Ai bashkërendon punën me të gjithë aktorët, ndërmjetëson pranë OJF-ve dhe strukturave të tjera shtetërore që ofrojnë shërbime, si policia, gjykata etj. Asiston viktimat për ndjekjen e procedurave për marrjen e urdhrave të mbrojtjes, mbikëqyr dhe përditëson dosjet e rasteve të referuara, mban lidhje me strukturat përgjegjëse, mban një bazë të dhënash, për rastet e referuara, harton raporte etj.

Përmes këtij studimi është matur vetëm koha e shpenzuar nga anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor dhe koordinatori/ja vendor/e në mekanizmat pranë Bashkisë Vlorë e Korçë, për hapat e kryer në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe të kostove për kryerjen e tyre. Nga studimi, pati disa gjetje dhe përfundime, të cilat po i paraqesim shkurtimisht si më poshtë.

3. GJETJET E STUDIMIT

Nga studimi rezultoi se Bashkia Korçë ka ngritur *Sistemin e reagimit të bashkërenduar kundër dhunës në familje*, mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit, më 19 maj 2010. Në përbërje të tij marrin pjesë 10 institucione. Gjithashtu, pranë kësaj bashkie, më 24 maj të vitit 2010, është ngritur dhe funksionon Zyra kundër dhunës në familje, si pjesë e Drejtorisë së shërbimeve sociale. Gjatë vitit 2012 kjo zyrë e ka zgjeruar veprimtarinë, duke përfshirë në funksionimin e saj edhe çështjet e barazisë gjinore.

Në Bashkinë Vlorë është ngritur dhe funksionon *Njësia e dhunës në familje*, më 2 nëntor 2009. Kjo njësi është përfshirë në strukturën e *Drejtorisë së ndihmës ekonomike dhe të shërbimit social*, pranë kësaj bashkie.

Në të dyja bashkitë e mësipërme është caktuar *Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare*, i cili është përfshirë në strukturën pranë zyrave të shërbimeve sociale në këto bashki. Nga intervista, është arritur në përfundimin se koordinatorët vendorë punojnë në mënyrë specifike për adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, në nivel vendor. Në Korçë, ky koordinator është përgjegjës edhe për çështjet e barazisë gjinore. Në të dyja bashkitë, koordinatorët kanë një bashkëpunim shumë të ngushtë me njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, të cilat janë krijuar pranë bashkive mbi bazën e ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës⁵.

Sikurse e theksuam, në Bashkinë Kukës nuk ishte caktuar koordinatori vendor. Megjithatë, problemet e dhunës në familje trajtohen nga pikat fokale për problemet e barazisë gjinore dhe të dhunës në familje, të vendosura në Drejtorinë e shërbimit

5 Ligji nr.10347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

social pranë Bashkisë. Gjithashtu, edhe pse aktorët përgjegjës në këtë bashki i njihnin përgjegjësitë e tyre që buronin në bazë të ligjit kundër dhunës në familje, ata nuk vepronin si një sistem i bashkërenduar.

Për sa më sipër, koha e punës dhe llogaritja e kostos përkatëse të punës së të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit, u realizua në bashkitë Vlorë dhe Korçë.

1. Kostoja e punës së koordinorit/es vendor/e

Nga studimi i pyetësorëve, në bazë të të cilëve u intervistuan koordinatorët vendorë të bashkive Vlorë dhe Korçë, kanë rezultuar gjetje, analiza e të cilave na çon në përfundime të rëndësishme në lidhje me koston e kohës që shpenzon një koordinator vendor, për çdo hap në veprimtarinë e tij bashkërenduese, menaxhuese e informuese; të kohës që ai shpenzon në lidhje me menaxhimin e një rasti konkret; të kohës që shpenzon për të bërë analizën e faktorëve që ndikojnë në këtë kosto, si dhe për të analizuar çështje të tjera të rëndësishme në lidhje zbatimin e VKM-së së mekanizmit të referimit dhe të ligjit kundër dhunës në familje.

Në punën e përditshme për trajtimin e çështjeve të dhunës në marrëdhëniet familjare koordinatorët vendorë trajtojnë çështje të lehta, tipike dhe të ndërlikuara.

Ata kanë pohuar se konsiderojnë **çështje të thjeshta çështjet në të cilat dhuna është në fillimet e saj, dhuna nuk ka arritur në forma të rënduara, prandaj në këtë fazë mund të ndërhyhet, për parandalimin e këtij fenomeni.**

Janë konsideruar si **çështje tipike**, çështjet që lidhen me dhunën në marrëdhëniet familjare të ushtruar midis bashkëshortëve. Kjo

gjetje përkon edhe me përfundimet e studimeve monitoruese të kryera nga aktorë të ndryshëm, në të cilat rezultoi se dhuna, në përqindjen më të lartë, është e pranishme në marrëdhëniet bashkëshortore⁶. Gjithashtu, një çështje tipike për koordinatorët vendorë përbën ajo çështje për të cilën dhuna në marrëdhëniet familjare denoncohet nga viktimat, një pjesëtar i familjes së viktimës, ose një komshi i saj.

Koordinatorët vendorë të intervistuar kanë konsideruar si *çështje të ndërlukuara* rastet kur viktimat e dhunës kanë nevojë për strehim. Ndodh që, në momentin që kanë këtë nevojë, strehëza nuk ka shtretër të lirë (nëse i referohemi intervistës me përfaqësuesen e strehëzës në Korçë, na u pohua se kjo strehëz ka vetëm tre shtretër). Gjithashtu, të ndërlukuara konsiderohen rastet kur, përveç viktimës, dhunohet edhe fëmija, kur dhuna shoqërohet edhe me probleme të theksuara ekonomike, si dhe kur viktimat e dhunës kërcënohet seriozisht për jetën.

Ka rezultuar se për të menaxhuar një rast, koordinatorët vendorë ndjekin disa nga hapat, të cilët janë përcaktuar në VKM-në e mekanizmit të referimit, si dhe në ligjin kundër dhunës në familje. Për secilin nga hapat e kryer për menaxhimin e rastit, koordinatori vendor shpenzon një kohë të caktuar, e cila është llogaritur në tërësi për rastin, është kthyer në kosto financiare, bazuar në pagën e koordinatorit vendor në muaj, si dhe në pagën e një ore, për këtë aktor. Meqenëse rezultoi se, për disa nga aktorët e intervistuar një çështje tipike ishte e barasvlershme me një çështje të lehtë, ne vendosëm që t'i përmbledhnim të dhënat duke i klasifikuar ato në dy kategori çështjesh: të thjeshta dhe të ndërlukuara.

6 Shih www.gag-al.org, Raporte monitoruese të zbatimit të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

1.1 Koordinatori vendor, Bashkia Korçë

Koordinatori vendor pranë kësaj bashkie, **për të menaxhuar një rast të thjeshtë dhune në familje**, ndjek hapat si më poshtë:

- u ofron viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare gatishmëri dhe mbështetje në mënyrë të bashkërenduar me aktorët e tjerë;
- referon rastin tek aktorët përkatës, sipas nevojave të rastit, kryesisht te punonjësi i policisë;
- u ofron viktimave mbështetje psikologjike;

Për të menaxhuar një rast të thjeshtë dhune, në Bashkinë Korçë, koordinatori vendor shpenzon 85 minuta, ose 1 orë e 25', dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 333 lekë.

Ka rezultuar se **për të menaxhuar një rast të ndërlikuar**, koordinatori vendor, pranë kësaj bashkie, ndjek hapat si më poshtë:

- referon viktimën e dhunës në polici;
- referon viktimën e dhunës në strehëz;
- referon viktimën e dhunës në organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për viktimat;
- shoqëron viktimën e dhunës në gjykatën e rrethit gjyqësor;
- përgatit të dhënat e rastit;
- ofron asistencë ligjore, informim për të drejtat e parashikuara në ligj;
- ofron asistencë psikologjike;
- ofron një paketë ushqimore në mbështetje të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

Duke përdorur të dhënat e mësipërme, mund të gjejmë mesatarisht kohën dhe koston për menaxhimin e një rasti dhune në familje.

Arrijmë në përfundimin se, **mesatarisht, koha që shpenzon koordinatori vendor pranë Bashkisë Korçë për menaxhimin e një rasti dhune në familje është 162 minuta, ose 2 orë e 42', me kosto 642 lekë.**

1.2. Koordinatori vendor, Bashkia Vlorë

Ka rezultuar se në Bashkinë Vlorë koordinatori vendor kryen hapat e mëposhtëm **për menaxhimin e një rasti të thjeshtë**:

- bisedon me viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- referon rastin në aktorët përkatës, sipas nevojave;

Për përmbushjen e këtyre detyrave në Bashkinë Vlorë, ka rezultuar se koordinatori vendor shpenzon 100 minuta, ose 1 orë e 40', për menaxhimin e një rasti të thjeshtë, me kosto të kohës së shpenzuar 371 lekë⁷.

Për të menaxhuar një rast të ndërlikuar, koordinatori vendor ndjek hapat si më poshtë:

- bisedon me viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare;
- shoqëron viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare për mjekim në qendrat shëndetësore;
- përgatit vlerësimin për gjykatën e rrethit gjyqësor;

Totali i kohës që shpenzon koordinatori vendor në Vlorë për të menaxhuar një rast të ndërlikuar është 410 minuta, ose 6 orë e 50', me kosto 1 578 lekë.

7 Diferenca në pagë midis koordinatorit vendor në Korçë dhe Vlorë është 1 000 lekë.

Mesatarisht, koha që shpenzon koordinatori vendor pranë Bashkisë Vlorë për menaxhimin e një rasti dhune në familje është 255 minuta, ose 4 orë 15', me kosto 975 lekë.

C. Detyra të tjera administrative

Koordinatori vendor në bashki, përveç menaxhimit të një rasti të dhunës në familje, të thjeshtë apo të ndërlikuar, kryen edhe disa detyra shumë të rëndësishme, të cilat janë të lidhura me punën që ai bën për bashkërendimin e aktorëve, të cilët janë pjesë e mekanizmit të referimit, si dhe detyra të tjera informuese dhe ndërgjegjësuere.

Koordinatorët vendorë të të dyja bashkive deklaruan se në zbatim të VKM-së, praktikisht, secili prej tyre kryen këto detyra të tjera administrative:

- drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor;
- ndërmerr iniciativa dhe organizon takimet e ekipit teknik ndërdisiplinor;
- bashkërendon ekipin teknik ndërdisiplinor për raste që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme;
- siguron burime ose shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme;
- ndërmjetëson me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/ organizata, për të dhënë informacion për referimin e viktimave në shërbime, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;
- ndihmon viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje/urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje, si dhe

- për hapat që duhet të ndiqen nëse urdhri i mbrojtjes shkelet;
- shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe pranë shërbimeve të tjera;
 - harton një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim etj.) dhe e rifreskon atë vazhdimisht;
 - siguron që dosjet dhe dokumentacioni rreth klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar;
 - përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor, në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave;
 - ndan një herë në muaj një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor;
 - siguron që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës;
 - mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje;
 - mbështet shërbimin me materiale ose me botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuere për dhunën;
 - bashkërendon veprimtarinë e institucioneve në nivel vendor dhe referon rastet e dhunës në familje;
 - propozon krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së qeverisjes vendore.

Një mbështetje për punën e koordinatorit vendor ka përbërë bashkëpunimi me policinë dhe organizatat jofitimprurëse, në nivel vendor. Kështu, organizatat jofitimprurëse, si qendra psikosociale “Vatra”, dhe qendra “Aulona” në Vlorë, si dhe fondacioni “Kenedi” dhe qendra “Hënëza e Re” në Korçë, i kanë dhënë zhdërvjelltësi sistemit të reagimit të bashkërenduar të komunitetit për adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, ngritur në këto bashki.

Nga analiza e pyetësorëve u përfundua në sa vijon:

Në Bashkinë Vlorë, koha që shpenzon koordinatori vendor për kryerjen e detyrave të tjera administrative në zbatim të VKM nr.334, datë 17.2.2011, të mekanizmit të referimit, është 1 700 minuta, ose 28 orë e 20’ me kosto 6 573 lekë.

Në Bashkinë Korçë, koha që shpenzon koordinatori vendor për kryerjen e detyrave të tjera administrative në zbatim të VKM nr.334, datë 17.2.2011, është 3540 minuta, ose 59 orë, me kosto 14 049 lekë.

Vëmë re se ka diferencë në kohën dhe koston e shpenzuar për kryerjen e detyrave të tjera administrative midis koordinatoreve vendorë të të dyja bashkive. Koha më e gjatë që shpenzon koordinatori vendor në Bashkinë Korçë për kryerjen e këtyre detyrave gjen pasqyrim në një funksionim dhe organizim më të qëndrueshëm të mekanizmit të referimit, mbledhje më të shpeshta të ekipit teknik ndërdisiplinor, si dhe vazhdimësi më të mirë në kryerjen e detyrave të tjera administrative në zbatim të VKM-së.

Çfarë mbetet për t’u përmirësuar?

Disa nga detyrat e përcaktuara në VKM, për të cilat u arrit në përfundimin se koordinatorët vendorë nuk i kanë kryer gjatë kësaj periudhe, janë:

- informimi në komitetin drejtues për ecurinë e punës;
- marrja e informacionit nga anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor për trajtimin e rasteve;
- bashkërendimi dhe organizimi i trajnimeve të ndërmarra nga MPÇSShB për anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor;
- hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve;
- paraqitja e raporteve për komitetin drejtues.

Pra, për pasojë të këtyre përfundimeve të mësipërme, del e nevojshme që bashkërendimi midis tri hallkave të Mekanizmit të bashkërendimit dhe referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, (d.m.th. midis Komitetit Drejtues, Ekipit teknik ndërdisiplinor dhe Koordinatorit vendor, si dhe shkëmbimi i informacionit midis tyre), ka nevojë të përmirësohet. Në këtë situatë një rol të rëndësishëm luan Koordinator vendor.

Ky studim përbën një foto të momentit kur janë kryer intervistat. Puna e aktorëve të intervistuar ka shënuar në vijim përmirësim të ndjeshëm, të cilin ne e prekim në punën tonë të përditshme me viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Ne mendojmë se, nëse do të rikostonim punën e aktorëve të intervistuar, koha e shpenzuar për kryerjen e detyrave dhe kostoja e punës së tyre do të rezultonte më e lartë. Kryerja e këtyre detyrave dhe një komunikim e bashkërendim më i mirë i punës midis këtyre tri hallkave dhe institucioneve përgjegjëse që bëjnë pjesë në to, mendojmë se do të sillte efekte në uljen e kohës dhe koston për menaxhimin nga Koordinator vendor të një rasti dhune në familje.

2. Kostoja e punës së Gjykatës së rrethit gjyqësor⁸

Përlllogaritja e kostonë së punës për kohën e harxhuar nga Gjykata dhe Policia, është kryer paraprakisht në Raportin **“Një studim i kostove të dhunës në familje në Shqipëri”**, të përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare për vitin 2011. Koha që këta aktorë të rëndësishëm shpenzojnë në kuadër të funksionimit të mekanizmit të referimit, rezulton të përbëhet nga koha e aktorit për menaxhimin e rastit dhe koha e shpenzuar për kryerjen e detyrave të tjera administrative. Konkretisht:

Mesatarisht, koha e shpenzuar nga gjyqtari në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Korçë, për lëshimin e UMM/UM është 435 min, ose 7 orë e 15’, dhe kostoja e bazuar në kohën e punës së gjyqtarit është 5 039 lekë.

Koha e shpenzuar nga gjyqtari në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Vlorë, për lëshimin e UMM/UM është 358 min, ose përafërsisht 6 orë, dhe kostoja e bazuar në kohën e punës së gjyqtarit është 4 147 lekë.

Detyra të tjera administrative

Koha e shpenzuar nga gjykata, në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Korçë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 60 minuta, ose 1 orë, dhe kostoja është 696 lekë.

Koha e shpenzuar nga gjykata, në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Vlorë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 90 minuta, ose 1 orë e 30’, dhe kostoja është 1 044 lekë.

⁸ Në lidhje me kostonë e kohës së punës së gjykatave referohu në: Raportin e QNL-së, **“Një studim i kostove të dhunës në familje në Shqipëri”**, Tiranë 2011.

3. Kostoja e punës së strukturës së policisë

Referuar raportit të sipërpërmendur në lidhje me policinë, rezultojnë këto të dhëna:

Mesatarisht, koha e shpenzuar nga punonjësi i policisë në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Vlorë, për adresimin e një rasti dhune në familje, është 258 minuta, ose 4 orë e 18', me kosto 1 314 lekë.

Koha e shpenzuar nga punonjësi i policisë në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Korçë, për adresimin e një rasti dhune në familje, është 306 minuta, ose 5 orë e 6', me kosto 1 559 lekë.

Detyra të tjera administrative

Koha e shpenzuar nga punonjësi i policisë në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Vlorë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 90 minuta, ose 1 orë e 30', me kosto 459 lekë.

Koha e shpenzuar nga punonjësi i policisë në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Korçë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 60 minuta, ose 1 orë, me kosto 306 lekë.

4. Kostoja e punës së përfaqësuesit të Drejtorisë arsimore

Anëtar i strukturës së ekipit teknik ndërdisiplinor në mekanizmin e bashkërendimit dhe referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare është edhe përfaqësuesi i Drejtorisë arsimore. Kjo e

fundit ka një rol shumë të rëndësishëm në trajtimin e problemeve të dhunës në familje, kryesisht të dhunës ndaj fëmijëve të mitur në shkolla. Në fakt, mekanizmi i bashkërendimit sipas VKM-së, për këtë aktor, mbështetet në përgjegjësitë ligjore që u burojnë aktorëve nga ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. **Prandaj, bazuar në këtë ligj, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka këto detyra:**

- a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta, për rregullat e sjelljes në familje;
- b) përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Nga intervistat e kryera me përfaqësues të drejtorive arsimore, ka rezultuar se **në programet mësimore trajtohen edhe çështjet e dhunës në familje. Gjithashtu, punohet në orë të posaçme edhe për ndërgjegjësimin e nxënësve dhe të prindërve mbi këtë fenomen. Drejtoritë arsimore kontribuojnë për trajnimin e mësuesve/edukatorëve në shkolla dhe kopshte publike, si dhe jo publike. Gjithashtu, psikologu në shkolla luan një rol të rëndësishëm për adresimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në familje. Janë menaxhuar raste kur fëmijët janë dhunuar drejtpërsëdrejti në këto marrëdhënie, ose kur kanë asistuar në skena dhune brenda familjes.**

Ligji nr.10329, datë 30.09.2010 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare», i ndryshuar, solli ndryshime të rëndësishme në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje. Në nenin 13 të tij, kanë të drejtë për të kërkuar urdhër mbrojtjeje për të miturit edhe personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët. Në grupin e personave ligjërisht përgjegjës përfshihet

edhe mësuesi në shkollë. Nga intervistat e kryera nuk na ka rezultuar të jetë shpenzuar kohë dhe kosto për përdorimin e kësaj të drejte, si subjekte që legjitimohen të kërkojnë urdhra mbrojtjeje për të miturit. Pra, nga përfaqësuesi i Drejtorisë arsimore shpenzohet kohë për menaxhimin e një rasti të dhunës në familje vetëm në kuadrin e reagimit të bashkërenduar.

Konkretisht, në lidhje me menaxhimin e një rasti të thjeshtë dhune në familje nga përfaqësuesi i arsimit:

Koha dhe kostoja e përfaqësuesit të arsimit ka rezultuar si vijon:

Në Vlorë është 250 minuta, ose 4 orë e 10', me kosto 716 lekë.

Në Korçë është 235 minuta, ose 3 orë 55', me kosto 1 092 lekë⁹.

Ndërsa, në lidhje me menaxhimin e një rasti të ndërlikuar dhune në familje:

Koha dhe kostoja e përfaqësuesit të arsimit rezulton:

Në Vlorë, koha e shpenzuar është 450 minuta, ose 7 orë e 30', me kosto 1342.5 lekë.

Në Korçë, koha e shpenzuar është 445 minuta, ose 7 orë 25', me kosto 2 072 lekë.

Mesatarisht, bazuar në koston e shpenzuar për trajtimin e një rasti të thjeshtë dhe të ndërlikuar dhune në familje, nga përfaqësuesi i arsimit, koha e shpenzuar nga ky aktor për menaxhimin e një rasti dhune në familje në Vlorë është 350 minuta, ose 5 orë e 50', me kosto 1029 lekë.

Koha e shpenzuar nga ky aktor për menaxhimin e një rasti dhune në familje, në Korçë, është 340 minuta, ose 5 orë e 40', me kosto 1 582 lekë.

9 Kjo gjetje shpjegohet me diferencën në pagë midis aktorëve të intervistuar.

C. Detyra të tjera administrative

Detyra të tjera administrative përfaqësuesi i arsimit kryen për diskutimin e kurrikulave, si dhe për pjesëmarrjen në aktivitetin e mekanizmit të referimit, veçanërisht në mbledhjet e tij, për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje ndaj fëmijëve. Prandaj, rezultoi:

Koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i arsimit në Vlorë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 90 minuta, ose 1 orë e 30', me kosto 269 lekë.

Koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i arsimit në Korçë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 60 minuta, ose 1 orë, me kosto 280 lekë.

5. Kostoja e punës së përfaqësuesit të Drejtorisë së shëndetit publik

Shërbimet e urgjencës dhe qendrat shëndetësore kanë detyra shumë të rëndësishme për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Bazuar në ligjin kundër dhunës në familje, shërbimet e urgjencës dhe qendrat shëndetësore në bashki e komuna kanë për detyrë të ofrojnë në çdo kohë ndihmë mjekësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje, të kryejnë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme, të venë në dukje rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, të pajisin viktimën me raportin mjekësor përkatës, ta përcjellin dhe ta orientojnë atë pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

Nga analiza e të dhënave të pyetësorëve dhe intervistave të kryera me përfaqësues të shëndetit publik ka rezultuar se, në menaxhimin e një rasti të thjeshtë ose të ndërlikuar, hapat që ata

kryenin ishin në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji kundër dhunës në familje dhe VKM-ja për mekanizmin e referimit.

Disa nga hapat e kryer nga përfaqësuesi i shëndetit publik **në menaxhimin e një rasti të thjeshtë**, janë: identifikimi i rastit, ekzaminimi i viktimës, ofrimi i ndihmës mjekësore, ofrimi i ndihmës psikologjike, lëshimi i raportit mjekësor, orientimi dhe referimi i viktimës në shërbime të tjera, transportimi i viktimës, këshillimi i viktimës.

Për rrjedhojë, në lidhje me menaxhimin e një rasti të thjeshtë:

Në Vlorë, koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik është 435 minuta, ose 7 orë e 15', dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 1 146 lekë.

Në Korçë, koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik është 345 minuta, ose 5 orë e 45 min, dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 909 lekë.

Në menaxhimin e një rasti të ndërlikuar **përfaqësuesi i shërbimit shëndetësor kryen të njëjtat veprimtari sikurse në menaxhimin e një rasti të thjeshtë, por për një kohë më të gjatë, veçanërisht në ofrimin e ndihmës mjekësore dhe ekzaminimin e viktimës.**

Rezultoi se, koha **për menaxhimin e një rasti të ndërlikuar** nga përfaqësuesi i shërbimit shëndetësor, si dhe kostoja e saj, paraqiten si vijon:

Në Vlorë, koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik është 615 minuta, ose 10 orë e 15', dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 1 620 lekë.

Në Korçë, koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik për menaxhimin e një rasti të komplikuar

është 435 minuta ose 7 orë e 15 min, dhe kosto e kohës së shpenzuar është 1 146 lekë.

Përfundim në lidhje me menaxhimin e një rasti dhune në familje nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik:

Koha për menaxhimin e një rasti dhune në familje nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik në Vlorë është 525 minuta ose 8 orë 45', me kosto 1383 lekë.

Koha për menaxhimin e një rasti dhune në familje nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik në Korçë është 390 minuta, ose 6 orë e 30', me kosto 1 028 lekë.

Detyra të tjera administrative në lidhje me dhunën në familje kryhen gjatë veprimtarive të përbashkëta me aktorët e tjerë të mekanizmit të referimit, pranë bashkive përkatëse. Kështu, nga analiza e pyetësorëve, rezultoi:

Koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik në Vlorë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 90 minuta, ose 1 orë e 30', dhe kostoja e shpenzuar është 237 lekë.

Koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Shëndetit Publik në Korçë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative, është 60 minuta, ose 1 orë, dhe kostoja e shpenzuar është 158 lekë.

6. Kostoja e punës së përfaqësuesit të shërbimeve sociale pranë bashkisë

Zyrat e shërbimeve sociale pranë bashkive dhe komunave janë subjekte të cilat, nëse kanë dijeni për ushtrimin e dhunës në familje, legjitimohen të paraqesin në gjykatë kërkesë për lëshimin

e urdhrave të mbrojtjes për viktimat e mitura, si dhe kërkesë për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si në rastin kur viktima është e mitur, ashtu edhe kur është madhore. Gjithashtu, këto zyra luajnë një rol të rëndësishëm gjatë procesit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, në bashkëpunim me komisaritet e policisë dhe zyrën e përmbarimit, detyrim ky që buron nga ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Gjykata e rrethit gjyqësor dërgon kopje të vendimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes, në zyrën e shërbimit social pranë njësisë vendore të vendbanimit të palëve.

Për sa më sipër, zyrat e shërbimeve sociale janë aktor shumë i rëndësishëm i mekanizmit të bashkërendimit të punës së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor dhe referimit të rasteve të dhunës në familje.

Nga analiza e të dhënave të pyetësorëve dhe intervistave të kryera me përfaqësues të shërbimeve sociale ka rezultuar se, si në menaxhimin e një rasti të thjeshtë, ashtu edhe në menaxhimin e një rasti të ndërlikuar, ata kryejnë të gjithë hapat e nevojshëm, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga aktet ligjore, ligjit kundër dhunës në familje dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, për mekanizmin e referimit.

Konkretisht, momentet kryesore të punës që kryhen nga përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale për menaxhimin e një rasti të thjeshtë rezultuan:

- Biseda e përfaqësuesit të zyrës së shërbimeve sociale me viktimën;
- Orientimi i viktimës dhe përgatitja e dokumenteve për përfitimin e ndihmës ekonomike;
- Vizita në familjen e viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare, për të ndjekur respektimin e vendimit të gjykatës.

Për rrjedhojë, në lidhje me menaxhimin e një rasti të thjeshtë dhune nga përfaqësuesi i zyrës së shërbimit social, rezulton:

Në Korçë, ky përfaqësues shpenzon 58 minuta, ose afërsisht 1 orë, dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 268 lekë.

Në Vlorë, ky përfaqësues shpenzon 165 minuta, ose 2 orë e 45', dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 721 lekë.

Në rastin e çështjeve të ndërlikuara përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale, përveç hapave që ndërmerr gjatë menaxhimit të një rasti të thjeshtë, kontakton me organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbime të ndryshme për viktimat, si akomodim, shërbime të specializuara sipas nevojave etj.

Për rrjedhojë, në lidhje me menaxhimin e një rasti të ndërlikuar dhune, nga përfaqësuesi i zyrës së shërbimit social:

Në Vlorë, ky përfaqësues shpenzon 170 minuta, ose 2 orë e 50', dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 734 lekë.

Në Korçë, ky përfaqësues shpenzon 125 minuta, ose 2 orë dhe kostoja e kohës së shpenzuar është 536 lekë.

Përfundime

Koha mesatare e shpenzuar nga përfaqësuesi i zyrës së shërbimit social, për menaxhimin e një rasti dhunë në familje, në Bashkinë Vlorë është 168 minuta, ose 2 orë e 48', dhe kostoja mesatare është 728 lekë.

Koha mesatare e shpenzuar nga përfaqësuesi i zyrës së shërbimit social, për menaxhimin e një rasti dhunë në familje, në Bashkinë Korçë është 92 minuta, ose 1 orë e 32', dhe kostoja mesatare është 402 lekë.

Diferencat në koston e këtij aktori shpjegohen me diferencën në pagë midis përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale, që bëjnë pjesë në sistemin e reagimit të bashkërenduar, si dhe me ndryshimet në veprimtarinë e zyrave të shërbimeve sociale pranë bashkive, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore, në adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Detyra të tjera administrative

Nga përpunimi i pyetësorëve për kohën e shpenzuar në kryerjen e detyrave të tjera administrative, për të marrë pjesë në reagimin e bashkërenduar rezultoi:

Koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i zyrës së shërbimit social për kryerjen e detyrave të tjera administrative, në kuadër të pjesëmarrjes në mbledhje apo veprimtari të përbashkëta të aktorëve të mekanizmit të bashkërenduar, në Vlorë është 90 minuta, ose 1 orë e 30', me kosto 393 lekë.

Koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i zyrës së shërbimit social për kryerjen e detyrave të tjera administrative në Korçë është 60 minuta, ose 1 orë, me kosto 268 lekë.

Nga procesi i intervistimit rezultoi se zyrat e shërbimeve sociale nuk praktikojnë hartimin e kërkesave për urdhër mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje në emër të viktimave të dhunës në familje. Nëse ato do ta realizonin edhe këtë detyrë, e cila buron nga ligji kundër dhunës në familje, koha e shpenzuar prej tyre dhe kostoja e saj do të rezultonte më e lartë.

7. Kostoja e punës së punonjësit të zyrës së Përmbaramit

Ligji nr.9669, datë 8.12.2006 “Për masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, përcakton detyra shumë të rëndësishme për zyrat e përmbaramit, të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore për UMM dhe UM, në bashkëpunim me komisaritet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna. Masat që lidhen me largimin e dhunuesit/ses nga banesa, me realizmin e takimeve të prindërve me fëmijët e mitur, me detyrimin e dhunuesit/ses për të bërë pagesa periodike në favor të fëmijëve, apo anëtarëve të tjerë të familjes, janë masa që ekzekutohen nga zyra e Përmbaramit, në kuadrin e zbatimit të UMM/UM, në bashkëpunim me policinë dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Me ligjin nr.10329, datë 30.9.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, janë parashikuar ndryshime të rëndësishme, në lidhje me ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes nga zyra e Përmbaramit. Bazuar në këto ndryshime, gjykata e rrethit gjyqësor, në pjesën urdhëruese të vendimit të lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, urdhëron edhe dërgimin e vendimit pranë zyrës së Përmbaramit, për ekzekutim.

Nga intervistat e kryera me përfaqësues të zyrës së Përmbaramit Korçë dhe Vlorë, ka rezultuar se punonjësit e zyrës së Përmbaramit, krahas zbatimit të titujve të tjerë ekzekutivë, zbatojnë edhe vendimet gjyqësore të lëshimit të urdhrave të mbrojtjes. Gjithashtu, ka rezultuar se, për zbatimin e vendimit gjyqësor të UM ose UMM, për një çështje të thjeshtë ose të ndërlikuar, përmbaruesi gjyqësor kryen të gjithë hapat e përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile për ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe njëkohësisht ato të parashikuara nga ligji kundër dhunës në familje.

Përgjatë diskutimeve në tryeza, të përfundimeve paraprake të dala nga ky studim, punonjësit e zyrës së Përmbartimit në Korçë ngritën disa shqetësime në lidhje me ndarjen e punëve midis këtij organi dhe policisë së shtetit, për ekzekutimin e një urdhri mbrojtjeje. Sidoqoftë, këto probleme nuk u mbajtën parasysht në përpunimin e të dhënave dhe mbeten si çështje për diskutim në të ardhmen.

Përmbartuesit gjyqësorë kanë konsideruar **çështje të ndërlikuar**, çështjet në të cilat kontakti me dhunuesin është i vështirë, për shkak të adresës së pasaktë, kur në vendimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes përfshihen masa mbrojtëse të takimit me fëmijët, si dhe çështjet të cilat e kanë shumë të nevojshme praninë e psikologut për viktimën madhore ose të mitur, por ajo nuk mundësohet.

Një çështje tipike në veprimtarinë e përditshme të përmbartuesve është çështja kur të dhunuar janë bashkëshortja dhe fëmijët. Një çështje e thjeshtë për përmbartuesit gjyqësorë konsiderohet çështja ku përfshihen njerëz të shtresave të arsimuara ose të punësuar, sepse në këto raste palët njohin më mirë ligjin dhe mjetet ligjore që mund të përdorin për mbrojtje.

Disa nga faktorët që ndikonin në kohën e shpenzuar nga përmbartuesi gjyqësor lidheshin jo vetëm me ndërlikimet dhe vështirësitë e rastit të dhunës në marrëdhëniet familjare, por edhe me vendbanimin e palëve. Rastet e dhunës në familje nga zonat rurale kërkonin më shumë kohë në adresimin e tyre.

Në kohën që shpenzon përmbartuesi gjyqësor është përfshirë koha që ai punon si person i autorizuar nga gjykata për të shoqëruar viktimën ose dhunuesin deri në banesën e viktimës dhe për të mbikëqyrur largimin e pasurisë personale; koha e shpenzuar për ekzekutimin e vendimit për takimin e fëmijëve të mitur me prindërit, koha e shpenzuar për menaxhimin e rastit mbi

detyrimet ushqimore për fëmijët; koha e shpenzuar për pagesat periodike për personat në ngarkim, duke përfshirë edhe qiranë e banesës etj.

Disa nga hapat që rezultuan se ndiqeshin nga përmbaruesit gjyqësorë në zbatim të urdhrave të mbrojtjes **për një rast të thjeshtë**, janë:

- Regjistrimi i dosjes;
- Përgatitja e shkresës zyrtare për Komisaratin e Policisë;
- Përgatitja e shkresës zyrtare për zyrën e shërbimeve sociale;
- Vajtja në terren;
- Vënia në dijeni e dhunuesit për vendimin e urdhrin të mbrojtjes, masat mbrojtëse të përfshira në të, njohja me pasojat në rast të shkeljes së urdhrave të mbrojtjes;
- Përgatitja e praktikës së dosjes për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe Prokurorinë.

Nga përllogaritjet rezultoi sa vijon:

Tërësia e kohës që shpenzon përmbaruesi gjyqësor në Vlorë, për të menaxhuar një rast të thjeshtë, është 465 minuta, ose 7 orë e 45', me kosto 2 883 lekë.

Tërësia e kohës që shpenzon përmbaruesi gjyqësor në Korçë, për të menaxhuar një rast të thjeshtë, është 315 minuta, ose 5 orë e 15', me kosto 1 811 lekë.

Në **një çështje të ndërlikuar**, përpos procedurave në zbatimin e UM/UMM të një rasti të thjeshtë, përmbaruesi gjyqësor shpenzon kohë edhe për kallëzimin penal në rastet e pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, për takimin e psikologut me fëmijët, për përgatitjen e praktikave për Drejtorinë e Përgjithshme Përmbarimore, Prokurorinë etj.

Pra, në lidhje me **menaxhimin e një rasti të ndërlikuar**:

Koha që shpenzon përmbaruesi gjyqësor në Vlorë për të menaxhuar një rast të ndërlikuar është 1190 minuta, ose 19 orë e 58', me kosto 7 366 lekë.

Koha që shpenzon përmbaruesi gjyqësor në Korçë për të menaxhuar një rast të ndërlikuar është 510 minuta, ose 8 orë e 30', me kosto 2 933 lekë.

Diferencat në menaxhimin e një rasti të ndërlikuar lidhen me hapat e kryer, kohën e ndryshme të shpenzuar, si dhe me kohën e shpenzuar nga përmbaruesit gjyqësorë në rastet kur janë shkelur urdhrat e mbrojtjes. P.sh. përmbaruesi gjyqësor në Vlorë ka konsideruar të ndërlikuar rastin kur urdhri i mbrojtjes shkelet, për të cilin ai shpenzon kohë më shumë.

Koha mesatare në lidhje me koston e menaxhimit të një rasti dhune në familje, nga përmbaruesi gjyqësor:

Koha mesatare për menaxhimin e një rasti dhune në familje në Vlorë, nga përmbaruesi gjyqësor, është 828 minuta, ose 13 orë e 38'. Kostoja mesatare është 5 125 lekë.

Koha mesatare për menaxhimin e një rasti dhunë në familje në Korçë, nga përmbaruesi gjyqësor, është 412 minuta, ose 6 orë e 52'. Kostoja mesatare është 2 372 lekë.

Detyra të tjera administrative

Përmbaruesit deklaruan se kryenin edhe detyra të tjera administrative, si pjesëmarrja në mbledhjet e ekipit teknik ndërdisiplinor, përgatitja e statistikave etj. **Konkretisht, për këto detyra, përmbaruesi gjyqësor në Vlorë shpenzonte 90 minuta, ose 1 orë 30', me kosto 558 lekë. Kurse përmbaruesi**

gjyqësor në Korçë shpenzonte 60 minuta, ose 1 orë, me kosto 345 lekë.

Në lidhje me këto detyra, kanë rezultuar edhe problematikat me të cilat ata përballen. Ndër problematikat e përmendura renditen mungesa e burimeve dhe mjeteve që nevojiten për kryerjen me efektivitet të detyrave dhe përgjegjësive të tyre ligjore. Nevojat për organizimin e trajnimeve për përmbaruesit gjyqësorë, si dhe për shpenzime të ndryshme, shpenzime naftë, transporti dhe shpenzime telefoni. Këto nevoja ngrenë shqetësimin për buxhetimin e tyre.

8. Kostoja e punës për përfaqësuesin e prefekturës

Në kuadrin e mekanizmit të bashkërenduar të referimit të rasteve të dhunës në familje, përfaqësuesi i prefekturës kryen veçanërisht detyra bashkërenduese midis aktorëve të mekanizmit të referimit. Ata bashkëpunojnë me drejtoritë rajonale të punësimin, me qendrat komunitare të shëndetit mendor dhe organizata e fondacione të ndryshme. Në kuadrin e tryezave antitrafik, ata vënë në dukje dhe referojnë edhe raste ku dhuna në familje është e pranishme.

Në tërësi, nga intervistimi i përfaqësuesve të prefekturës, u arrit në përfundime në lidhje me kohën e shpenzuar prej tyre. Sikurse shihet, koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i Prefekturës Korçë është shumë më e lartë sesa ajo e Prefekturës Vlorë, pasi ata raportuan veprimtari më të dendur. Konkretisht:

Koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i prefekturës në Vlorë, për kryerjen e detyrave të tjera administrative dhe për referimin e një rasti dhune në familje, është 100 minuta, ose 1 orë e 40', me kosto 895 lekë.

Koha e shpenzuar për referimin e një rasti dhune në familje dhe kryerjen e detyrave të tjera administrative, nga përfaqësuesi i prefekturës në Korçë, është 240 minuta, ose 4 orë, me kosto 1 716 lekë.

9. Kostoja e punës për përfaqësuesin e zyrës së punës

Procesi i garantimit të mbrojtjes së viktimës së dhunës në familje dhe menaxhimi i rastit të saj është i lidhur ngushtë me rehabilitimin e viktimës, si në aspektin e përmirësimit të situatës së rëndë psikologjike, ashtu edhe me fuqizimin e saj ekonomik. Në këtë aspekt, merr një rëndësi të posaçme zyra përkatëse e punësimit, e cila ka detyrimin që të trajtojë dhe menaxhoje rastet e viktimave të dhunës në familje. Kështu, përfaqësuesi i zyrës së punës në mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës në familje, përbën një hallkë të rëndësishme, e kostuar gjatë këtij studimi.

Nga analiza e të dhënave të pyetësorëve, puna e punonjësve të zyrave të punësimit është e përqendruar në drejtim të informimit të viktimave të dhunës për tregun e punës, në programet e nxitjes së punësimit, në organizimet e kurseve kualifikuese profesionale, si dhe të ndërmjetësimit për punësim. Gjatë intervistimit të përfaqësuesve të zyrës së Punës, rezultoi se këta punonjës, krahas detyrave kryesore në punë, kryejnë edhe detyra që lidhen me adresimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe me mundësi trajnimi e punësimi. Të intervistuarit theksuan se në punën e tyre nuk bazohen në shkallën e vështirësisë së rastit të dhunës në familje, pasi në të gjitha kategoritë e rasteve ata i kryejnë të gjithë hapat.

Konkretisht, rezultoi se koha e shpenzuar nga përfaqësuesi i zyrës së Punës, për menaxhimin e një rasti dhune në familje, dhe kostoja e shprehur në lekë është si vijon:

Në Vlorë, përfaqësuesi i zyrës së Punës shpenzon 90 minuta, ose 1 orë e 30', me kosto 339 lekë.

Në Korçë, përfaqësuesi i zyrës së Punës shpenzon 50 minuta, me kosto 188 lekë.

Diferencat në kosto për përfaqësuesit e zyrës së Punës në Vlorë dhe Korçë lidhen jo vetëm me kohën e shpenzuar dhe hapat e kryer për adresimin e dhunës në familje, por edhe me diferencën në pagë midis tyre.

Detyra të tjera administrative

Koha për kryerjen e detyrave të tjera administrative, në kuadrin e pjesëmarrjes në aktivitetin e mekanizmit të referimit, nga zyra e Punës në Vlorë është 90 minuta, ose 1 orë e 30', me kosto 339 lekë.

Koha për kryerjen e detyrave të tjera administrative nga zyra e Punës në Korçë është 60 minuta, ose 1 orë, me kosto 226 lekë.

10. Kostoja e punës për punonjësit e strehëzave për viktimat e dhunës

Njësitë e qeverisjes vendore, përveç të tjerave, kanë detyrë edhe ngritjen e qendrave sociale për rehabilitimin e viktimave dhe të dhunuesit, si dhe bashkërendimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse.

Në të dy rrethet objekt intervistimi, funksionojnë dy strehëza. Në Vlorë, qendra psikosociale “Vatra” (organizatë jofitimprurëse); dhe në Korçë, fondacioni “Kenedi”, i cili gjithashtu funksionon në

zbatim të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”. Ne intervistuan përfaqësuesit e këtyre strehëzave, dhe nga ky intervistim u përfitua informacioni në vijim.

Bashkia Vlorë dhe qendra psikosociale “Vatra” kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi për të menaxhuar rastet e dhunës në familje, si dhe për të ofruar akomodim për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Kurse fondacioni “Kenedi” është kontraktuar nga Bashkia Korçë për të ofruar akomodim, si dhe për shërbime të tjera, që ky fondacion mundëson për viktimat e dhunës në familje.

Përfaqësuesit e strehëzave kanë konsideruar **rast të thjeshtë**, atë në të cilin është e pranishme dhuna fizike dhe emocionale jo vetëm ndaj bashkëshortit, por edhe ndaj fëmijëve. Në këto raste ato duhet të ofrojnë akomodim dhe shërbime, si për nënën ashtu edhe për fëmijën. Këto raste u kategorizuan së bashku me rastet e thjeshta të dhunës në familje, të cilat janë konsideruar të tilla prej tyre kur dhuna në marrëdhëniet familjare është ushtruar vetëm në formën psikologjike, e pa shoqëruar me dhunën fizike.

Rast i ndërlikuar është konsideruar, nga përfaqësuesit e strehëzave, ai në të cilin dhuna e ushtruar është e skajshme, kur është ushtruar dhunë seksuale, veçanërisht kur ka edhe dhunë seksuale nga prindi ndaj fëmijës.

Nga intervistat mësohet se përfaqësuesit e strehëzave kryenin disa hapa dhe përmbushnin detyrat jo vetëm në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga VKM-ja e mekanizmit të referimit, por edhe me standardet e miratuara të shërbimeve sociale. Konkretisht, përfaqësuesit e strehëzave në menaxhimin e një rasti tipik dhe të një rasti të ndërlikuar, kryejnë disa hapa, të cilët, sipas kohës së shpenzuar për çdo hap, kanë rezultuar në kosto.

Disa hapa të rëndësishëm të kryer nga punonjësit e strehëzës për menaxhimin e një rasti të thjeshtë dhune në familje janë:

- shqyrtojnë rastin dhe verifikojnë përmbushjen e kritereve;
- vlerësojnë nevojat e viktimës;
- e takojnë viktimën me punonjësin social për zhvillimin e intervistës dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm;
- ofrojnë akomodim për viktimat në strehëz;
- informojnë viktimën në lidhje me specifikën e strehëzës dhe rregulloren e saj;
- bashkërendojnë veprimet e strehëzës me avokaten, për t'i ofruar shërbim ligjor viktimës së akomoduar në strehëz;
- bashkërendojnë veprimet e strehëzës me zyrën e shërbimeve sociale në bashki;
- bashkërendojnë veprimet e strehëzës me policinë;
- mundësojnë takimin e viktimës me punonjësin social, në çdo 2-3 ditë;
- i ofrojnë viktimës ndihmë mjekësore, nëse nevojitet.

Totali i kohës dhe koston në lekë për një rast të thjeshtë, të shpenzuar nga përfaqësuesi i strehëzës, paraqitet si vijon:

Përfaqësuesi i strehëzës në Vlorë ka shpenzuar 640 minuta, ose 10 orë e 40'. Koha e shprehur në kosto është 2 205 lekë.

Përfaqësuesi i strehëzës në Korçë ka shpenzuar 630 minuta, ose 10 orë e 30'. Kjo kohë e shpenzuar, e shprehur në kosto, është 3 129 lekë.

Diferencat në kosto midis përfaqësuesit të strehëzës në Vlorë dhe përfaqësuesit të strehëzës në Korçë shpjegohen me diferencën në pagë midis të dy punonjësve. Diferencat në pagë shpjegohen

me faktin se funksionimi dhe mbështetja e strehëzave për të mbijetuarat e dhunës në familje mundësohet në kuadrin e projekteve dhe mbështetjeve të ndryshme financiare.

Për **menaxhimin e një rasti të ndërlikuar**, përfaqësuesi i strehëzës kryen të gjitha hapat që përmendëm më lart për menaxhimin e një rasti tipik. Gjithashtu, mbahen kontakte të shpeshta me aktorët, si p.sh. me policinë një herë në javë, si dhe me organe të tjera përgjegjëse. Të dhënat tregojnë për një rol shumë aktiv të strehëzave për të mbijetuarat, jo vetëm për akomodimin, por edhe për rehabilitimin e tyre. Në një rast të ndërlikuar është karakteristik zhvillimi i raporteve me median.

Është llogaritur se, në kohë dhe kosto, totali i shpenzuar nga përfaqësuesi i strehëzës për menaxhimin e një rasti të ndërlikuar është si vijon:

Për strehëzën Vlorë, nga përfaqësuesi i strehëzës janë shpenzuar 1 350 minuta, ose 22 orë e 30'. Koha e shpenzuar, e shprehur në kosto, është 4 680 lekë.

Për strehëzën Korçë, janë shpenzuar nga përfaqësuesi i strehëzës 1 140 minuta, ose 19 orë. Koha e shpenzuar, e shprehur në kosto, është 5662 lekë.

Diferencat në kosto, në lidhje me menaxhimin e një rasti të ndërlikuar në strehëzat Vlorë dhe Korçë janë krijuar nga fakti se në detyrat e kryera janë përfshirë detyra të tilla si: informimi i viktimave të dhunës në lidhje me faktin se strehëza është strehëz emergjente; bashkërendimi i veprimeve me zyrën e shërbimeve sociale në bashki; raportet e rregullta me median; bashkëpunimi i qëndrueshëm me policinë si dhe me organe të tjera mbështetëse. Kryerja e këtyre detyrave nga përfaqësuesi i strehëzës në Korçë ka rritur kohën dhe koston e trajtimit të një rasti të tillë. Në larminë e detyrave nga njëra strehëz te tjetra, duhet të marrim parasysh

edhe mundësitë që ofrojnë projektet e zbatuara prej tyre në mbështetje të të mbijetuarave nga dhuna në familje.

Duke përlogaritur koston mesatare **për menaxhimin e një rasti dhune në familje** rezultojnë si më poshtë:

Mesatarisht, koha që shpenzon punonjësi i strehëzës në Vlorë, për menaxhimin e një rasti dhune në familje, është 995 minuta, ose 16 orë e 35', me kosto mesatare 3 443 lekë.

Kostoja mesatare e punonjësit të strehëzës në Korçë, për menaxhimin e një rasti dhune në familje, është 885 minuta, ose 14 orë e 45', me kosto mesatare 4 396 lekë.

Detyra të tjera administrative

Përfaqësuesit e strehëzës shpjeguan se punonjësit kryejnë edhe detyra të tjera administrative në kuadër të reagimit të bashkërenduar. Këto veprimtari përbëhen nga përgatitja dhe pjesëmarrja në mbledhjet e ekipit teknik, si dhe nga kryerja e procedurave të përbashkëta me aktorë të tjerë.

Konkretisht:

Për detyrat e tjera administrative, del se në Vlorë punonjësi i strehëzës shpenzon 90 minuta, ose 1 orë e 30', me kosto 312 lekë.

Përfaqësuesi i strehëzës në sistemin e reagimit të bashkërenduar në Korçë, del se shpenzon 60 minuta, ose 1 orë, me kosto 298 lekë.

Pyetja që vijonte u drejtohej aktorëve për të parë se çfarë burime u nevojiten në punën e tyre për të qenë më efektivë. Punonjësit e strehëzave u përgjigjën se u nevojitet një mbështetje më e madhe financiare, për të mundur një numër më të madh shtretërish për akomodimin e të mbijetuarave nga dhuna në familje, si dhe të fëmijëve të tyre. Gjithashtu, punonjëset e strehëzave në Korçë dhe Vlorë ngritën shqetësimin e pjesëmarrjes dhe kontributit të të gjithë aktorëve në mbledhjen e ekipit teknik ndërdisiplinor. Përfshirja e aktorëve në përbërje të sistemit të reagimit të bashkërenduar, në mënyrë të vazhdueshme në mbledhjet e ekipit teknik ndërdisiplinor, do të rrisë efektivitetin e përgjigjes ndaj rasteve të dhunës në familje.

11. Kostoja e shpenzimeve që kryen viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare

Kjo kosto në vijim është kostoja e shpenzimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta (të tërthorta) që një viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare duhet të kryejë për denoncimin dhe ndjekjen pranë të gjitha hallkave të rastit të dhunës. Këto tabela janë hartuar duke pasur parasysh deklaratimet e viktimave të dhunës, të cilat janë përfaqësuar nga Qendra për Nisma Ligjore qytetare për të kërkuar urdhrat e Mbrojtjes dhe për të mbikëqyrur zbatimin e tyre.

Tabela nr.1

Nr.	1. Kostoja e shpenzimeve të drejtpërdrejta	A- Kostoja e të dëmtuarës	
		koha	kosto / lekë
	<i>paga referuese - 21 000 lekë</i>		
1	Shpenzime avokati	2 orë	250
2	Shpenzime transporti në polici, gjykatë	10 orë	1 250

3	Shpenzime për fotokopje të dokumenteve		1 000
4	Shpenzime telefoni		1 000
5	Koha për të paraqitur kërkesën për UMM/UM	1 orë	125
6	Koha për të marrë UMM/UM	1 orë	125
7	Vizita te mjekësia ligjore		500
8	Kryerja e analizave		1 500
9	Marrja e ilaçeve		1 700
10	Shpenzime të tjera		450
	Totali i shpenzimeve të drejtpërdrejta		7 900

Kosto të tërthorta

Tabela nr.2 pasqyron koston e shpenzimeve të tërthorta.

Tabela nr.2

Kostoja e shpenzimeve të tërthorta, paga referuese – 21 000 lekë	Koha	Kosto/lekë
Mosparaqitja në punë, humbja e ditës së punës	2 ditë pune	2 000
Kostoja për kujdesin ndaj fëmijëve	2 ditë pune	2000
Totali i shpenzimeve të tërthorta		4 000

Përfundimi: Totali i kostove të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të mbijetuarën nga dhuna në marrëdhëniet familjare është 11 900 lekë.

4. PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

1. Përmbledhje e përfundimeve

Në vijim po paraqesim në mënyrë grafike disa prej të dhënave kryesore në lidhje me kohën e shpenzuar nga të gjithë aktorët e mekanizmit të referimit për një rast të dhunës në familje. Këto të dhëna, së bashku me kurbën që pasqyron prirjen e rasteve të dhunës që ndiqen në një bashki, në një vit, mund të shërbejnë si model krahasimor në raste të tjera, me qëllim që të bëhen planifikimet dhe parashikimet e nevojshme në buxhetin qendror dhe vendor.

Tabela nr.3 paraqet të dhënat në lidhje me koston e menaxhimit të një rasti dhune në familje nga mekanizmi i bashkërendimit të punës së autoriteteve në nivel vendor dhe referimit të rasteve të dhunës në familje, pranë Bashkisë Vlorë.

Tabela nr.3

Nr.	Aktori	Koha e shpenzuar në min	Kostoja në lekë
1	Koordinatori/ja vendore	255	975
2	Shërbimet sociale	168	728
3	Zyra e përmbarimit	828	5 125
4	Strehëza	995	3 443
5	Zyrat e punës	90	339
6	Shëndetësia	525	1 383
7	Arsimi	350	1 029
8	Policia	258	1 314
9	Gjykata	358	4 147
	Totali	3 827	18 483

Grafiku nr.1





Tabela nr.4 paraqet të dhënat në lidhje me koston e menaxhimit të një rasti dhune në familje nga mekanizmi i bashkërendimit të punës së autoriteteve në nivel vendor dhe referimit të rasteve të dhunës në familje, pranë Bashkisë Korçë.

Tabela nr.4

Nr.	Aktori	Koha e shpenzuar	Kostoja
		Minuta	Lekë
1	Koordinatorja vendore	162	642
2	Shërbimet sociale	92	402
3	Zyra e përmbartimit	412	2 372
4	Strehëza	885	4 396
5	Zyrat e punës	50	188
6	Shëndetësia	390	1 028
7	Arsimi	340	1 582
8	Policia	306	1 559
9	Gjykata	435	5 039
Totali		3 072	17 208

Grafiku nr.2



Detyra të tjera administrative

Tabela në vijim tregon kohën e shpenzuar për kryerjen e detyrave të tjera administrative, nga aktorët e intervistuar në Bashkinë Vlorë dhe Korçë dhe koston në lekë.


Tabela nr.5

Nr.	Aktori	Bashkia Korçë		Bashkia Vlorë	
		Koha e shpenzuar/min	Kostoja në lekë	Koha e shpenzuar/min	Kostoja në lekë
1	Koordinatori/ja vendore	3 540	14 049	1 700	6 573
2	Shërbimet sociale	60	268	90	393
3	Zyra e përmbanimit	60	345	90	558
4	Prefektura	240	1 716	100	895
5	Strehëza	60	298	90	312
6	Zyrat e punës	60	226	90	339

7	Shëndetësia	60	158	90	237
8	Arsimi	60	280	90	269
9	Policia	60	306	90	459
10	Gjykata	60	696	90	1 044
Totali		4 260	18 342	2 520	11 079

Grafiku në vijim paraqet një vështrim krahasues të kostos së shpenzuar për kryerjen e detyrave të tjera administrative nga aktorët e intervistuar në Bashkinë Vlorë dhe Korçë.

Grafiku nr.3



Prirja e rasteve të dhunës në familje, sipas viteve, në Bashkinë Korçë

Tabela nr.6 tregon prirjen e rasteve të thjeshta dhe të ndërlikuara të trajtuara në vitet 2010, 2011 dhe 2012 në Bashkinë Korçë.


Tabela nr.6

Bashkia Korçë	Prirja në vite		
Vitet	2010	2011	2012
Raste të thjeshta	23	42	48
Raste të ndërlikuara	15	28	28
Totali i rasteve	38	70	76

Nga tabela thekson prirjen në rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje, të menaxhuara nga mekanizmi i referimit në Korçë, në vitet 2010, 2011 dhe 2012.

Në mënyrë grafike, prirja e trajtimit të rasteve të thjeshta dhe rasteve të ndërlikuara në vite në këtë bashki paraqitet në grafikun nr.4.

Grafiku nr.4




Sikurse vihet re nga grafiku nr.4, numri i rasteve të ndërlikuara gjatë viteve 2011 dhe 2012 ka shënuar rritje në raport me vitin 2010.

Kështu, në bazë të këtij studimi, duke pasur parasysh numrin e rasteve të dhunës në familje që trajtohen nga një aktor i caktuar i mekanizmit, për një periudhë kohore të caktuar, mund të kalojmë në gjetje të rëndësishme mbi koston e trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe gjetjen vend të kësaj kostoje në buxhetet përkatëse.

Tabela nr.7 Rastet e urdhrave të mbrojtjes në Bashkinë Korçë, sipas viteve, në raport me rastet e raportuara.

Vitet	2010	2011	2012
Totali i rasteve	38	70	76
Rastet me UMM/UM	13	40	52
Raporti i rasteve me UMM/UM me rastet në total (%)	34.21%	57.14%	68.42%

Grafiku 5. Raporti i rasteve me UMM/UM, në Bashkinë Korçë



Grafiku nr.5 tregon prirjen në rritje të rasteve me UMM/UM në raport me totalin e rasteve të raportuara të dhunës në marrëdhëniet familjare, nga viti 2010, në vitin 2011 dhe 2012.

Kryerja për herë të parë e një ushtrimi mbi koston e zbatimit të ligjit kundër dhunës në familje dhe mekanizmit të bashkërendimit e referimit të rasteve të dhunës, i hap rrugën një diskutimi shumë të rëndësishëm, mbi faktin sesa buxhetet qendrore e ato vendore adresojnë mbrojtjen nga dhuna në familje dhe nga diskriminimi për shkaqe gjinore.

Përfshirja e analizës gjinore në buxhetim, përbën një mjet të rëndësishëm për arritjen e barazisë gjinore. Këtij qëllimi i shërben edhe analiza e kostos për menaxhimin e një rasti të dhunës në familje nga mekanizmi i referimit.

Duke analizuar gjetjet e mësipërme, u vu re se ka disa mungesa në punën e kryer në kuadrin e mekanizmit të referimit.

Deri në momentin e skanimit të situatës nga ky studim ka rezultuar se çështja e dhunës në familje është buxhetuar në mënyrë të limituar nga buxhetet vendore të Vlorës e Korçës. Ndërkohë, detyrat janë realizuar në kuadrin e projekteve të mbështetura nga donatorë të ndryshëm.

Disa prej aktorëve të mekanizmit nuk kanë emërtuar një person përgjegjës për përfaqësimin e organit në ekipin teknik të mekanizmit. Kjo është e nevojshme të kryhet sa më parë, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe cilësisë së përfaqësimit në ekip.

U vërtetua se vetëm disa prej aktorëve janë aktivë në mbledhjet e ekipit teknik, kurse të tjerë kanë mbetur pasivë. Rezultoi se, veçanërisht policia, koordinatori vendor dhe organizatat jofitimprurëse janë hallkat më aktive të mekanizmit.

U vu re se në rrethe Vlorë e Korçë ishte ngritur e funksiononte mekanizmi i referimit, ndërsa në Kukës, hallkat e mekanizmit të referimit vepronin të veçuara, ndërkohë që nuk ishte emëruar ende Koordinator Vendor.

2. Sugjerime:

1. Organet e njësive vendore (bashkitë) të parashikojnë në planet e tyre të zhvillimit masa konkrete për funksionimin dhe rritjen e efektivitetit të mekanizmit të referimit, të cilat duhet të buxhetohen në mënyrë të arsyeshme, të qëndrueshme dhe progresive.
2. Në planifikimin e buxhetit të shtetit të mbahen parasysh edhe buxhetimet për zbatimin e mekanizmit të referimit në njësitë vendore.
3. Sugjerohet të mbahen parasysh ekzemplarët e analizuar nga ky studim, për planifikimet përkatëse në buxhetet vendore e qendrore.
4. Sugjerohet kryerja nga aktorë të ndryshëm dhe në vazhdimësi, e analizave të buxhetit nga perspektiva gjinore dhe impaktit që ato kanë mbi të dyja gjinitë, si dhe me orientim nga të drejtat e njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtat e grave.
5. Sugjerohet kryerja e analizave gjinore të buxheteve qeveritare edhe në nivel vendor, si një mjet monitorimi dhe përqasjeje me Konventën CEDAW.
6. Sugjerohet të forcohet puna për funksionimin e mekanizmit të referimit në Bashkinë Kukës.
7. Sugjerohet që bashkitë e Tiranës, Kukësit, Korçës dhe Vlorës të kryejnë vlerësime të përfituesve dhe të pasqyrojnë nevojat e tyre në buxhete.
8. Sugjerohet të forcohet buxhetimi me pjesëmarrje të publikut në nivel bashkie, me qëllim që qytetarët të shprehin nevojat e tyre, të cilat duhet të gjejnë vend në buxhete.

9. Sugjerohet trajnimi i vazhdueshëm i koordinatorëve vendorë, dhe i përfaqësuesve të nivelit teknik në ekipin teknik ndërdisiplinor, me qëllim rritjen e efektshmërisë së të gjithë aktorëve pjesëtarë të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.
10. Sugjerohet që të gjithë aktorët e mekanizmit të referimit të marrin masat e nevojshme për caktimin e personave përgjegjës, si përfaqësues të institucionit në ekipin teknik dhe për trajnimin e kualifikimin e tyre të vazhdueshëm.
11. Sugjerohet që të gjithë aktorët e mekanizmit, në mënyrë të posaçme organizatat e shoqërisë civile, të bashkëpunojnë me median dhe me organet e zgjedhura vendore, për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë mbi koston që i kushton shoqërisë adresimi i dhunës në familje dhe nevojën e parandalimit të saj me mjete të ndryshme.

BIBLIOGRAFIA

Ligje

- Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ligji kundër dhunës në familje.
- Ligji nr.10329, datë 30.09.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”.
- Ligji 23/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar.
- Ligji nr.10347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

VKM

- Vendimi i Këshillit të Ministrave, (VKM) nr.334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Raporte

- www.gag-al.org, Raporte.
- QNL, “Një studim i kostove të dhunës në familje në Shqipëri”, Raport, Tiranë 2011.

Botime

- Diane Elson, Budgeting for Women’s Rights, Monitoring Government Budgets for Compliance with CEDAW, 2006. United Nations Development Fund for Women (UNIFEM).

Aneksi 1.

Modeli i pyetësorit të përdorur

1. Skeda e intervistës për koordinatorin vendor

Faleminderit për kohën që më dhatë për të biseduar bashkë. Unë jam një eksperte, studiuese, që po kontribuoj në zbatimin e projektit të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare mbi koston e Mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, në zbatim të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe VKM nr.334 datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkëpunimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Ne jemi duke e kryer këtë studim për të parë se cila është kostoja e Mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në zbatim të ligjit kundër dhunës në familje. Ne shpresojmë që ky informacion të mund të përdoret për të vlerësuar buxhetin që nevojitet që koordinatori vendor të kryejë punën efektivisht në zbatim të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe VKM nr.334 datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkëpunimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Data e intervistës:	Koha e fillimit:
Bashkia:	Koha e përfundimit:
Dita e javës:	Koordinatori vendor:

Emri:	
Pozicioni:	
Numri i viteve që punoni:	
Paga bruto aktualisht:	
Sa orë punoni ju zakonisht çdo ditë?	

1a. Në punën që ju bëni a trajtoni vetëm raste të dhunës në familje?

PO JO

1b. Nëse jo, çfarë lloj çështjesh të tjera trajtoni?

1c. Sa orë shpenzoni në ditë për trajtimin e çështjeve të tjera, të ndryshme nga dhuna në familje?

1d. Në bashkinë ku ju punoni, a ka persona të tjerë që janë ngarkuar të punojnë me dhunën në familje?

1.e Do të doja t'ju drejtoja disa pyetje në lidhje me llojet e çështjeve që ju trajtoni.

- 2.** Cili është lloji i çështjes së dhunës në familje, duke përfshirë çështjet me kërkesë për urdhër mbrojtje, që ju trajtoni? A mund të përshkruani një çështje tipike për mua, cilën çështje konsideroni tipike? (p.sh. çfarë ndodh, çfarë ndihme kërkohet nga ju? Si përfshihet koordinatori vendor? Sa në 10 çështje janë të tilla?
-
-

- 2.1.** Cila çështje konsiderohet nga ju një çështje e ndërlikuar? Sa shpesh e takoni një çështje të ndërlikuar? (sa në 10 çështje janë të tilla?)
-
-

- 2.2.** Cila çështje konsiderohet nga ju një çështje e lehtë? Sa shpesh e takoni çështjet e lehta? (vlerësoni, sa në 10 çështje janë të tilla?)
-
-

Duke menduar rreth kësaj çështjeje tipike, lloji i çështjes që ju takoni më shpesh, ju lutem përshkoni të gjitha hapat që ju ndiqni kur trajtoni këtë çështje. Ndërsa përshkruajmë çdo hap, unë do të doja t'ju pyesja se sa kohë shpenzoni në çdo hap.

(Shënim për intervistuesin: Shpjegoni që ju jeni të interesuar të dini se çfarë është tipike në lidhje me kohën që kërkon trajtimi i saj. *Lejoji të intervistuarit së pari të identifikojnë hapat që duhet të ndjekin.*

Më pas, kur ata thonë se nuk kanë asgjë tjetër, kaloni te gjërat e tjera që ju e dini që ata duhet të bëjnë. Shënoni qartë sa i besoni çfarë thanë pas kësaj dhe sa hapa u përmendën spontanisht.

Gjithashtu pyesni pas dhënies së shifrës tipike,

(i) cila është koha më e gjatë që çdo veprimtari merr kur trajtojnë një çështje të ndërlikuar; Cilat gjëra e ndërlikojnë çështjen; dhe të vlerësohet në çfarë përqindje të 10 ose 50 çështjeve faktorë/ ngjarje të tilla mund të ngrihen.

(ii) Cila është koha më e shkurtër që çdo veprimtari merr, kur kanë një çështje të lehtë; çfarë ndihmon të shpejtojë çështjen; dhe të vlerësohet në çfarë përqindje të 10 ose 50 çështjeve faktorë/ ngjarje të tilla mund të ngrihen.)

ÇËSHTJA TIPIKE

Hapi	Koha që ju merr

ÇËSHTJA E NDËRLIKUAR

Hapi	Faktori Komplikues	Koha që ju merr	Koha e shpenzuar

ÇËSHTJA E LEHTË

Hapi	Faktori Komplikues	Koha që ju merr	Koha e shpenzuar

- 3.** Detyra të tjera në zbatim të VKM nr.334 datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkëpunimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” dhe koha e shpenzuar për kryerjen e tyre-orë/muaj ose orë /ditë.

Koha e harxhuar për:

- drejtimin e punës së ekipit teknik ndërdisiplinor - ... orë;
- ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet e këtij ekipi - ... orë;
- informon për ecurinë e punës së tij komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje (përgatitjen e informacionit) - ... orë;
- bashkërendon ekipin teknik ndërdisiplinor për raste që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme - ... orë;
- siguron burime ose shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme - ... orë.
- Koha e harxhuar si ndërmjetës me OJF-të, policinë, shërbimet shëndetësore, gjykatat, shërbimet sociale, dhe të tjera institucione/organizata referimi, për të dhënë

informacion, për t'i lidhur viktimat me shërbimet dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre - ... orë.

- Koha e harxhuar për të asistuar viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe për hapat që duhen ndjekur nëse urdhri shkelet - ... orë.
- Koha e harxhuar për të shoqëruar viktimat e dhunës në gjykatë - ... orë, polici - ... orë dhe pranë shërbimeve të tjera - ... orë.
- Koha e harxhuar për të hartuar një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim etj.) dhe rifreskimin e listës vazhdimisht - ... orë.
- Koha e harxhuar për të siguruar që dosjet dhe dokumentacioni rreth klientëve të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar - ... orë.
- Koha e harxhuar për të përditësuar të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ekipi teknik ndërdisiplinor, në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave - ... orë.
- Koha e harxhuar për të ndarë një herë në muaj një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me të gjithë anëtarët e ekipit teknik ndërdisiplinor - ... orë.

Secili anëtar i ekipit ndërdisiplinor ka përgjegjësi që të përcjellë te koordinatori një herë në dy javë informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij/saj, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore, apo është trajtuar vetëm brenda për brenda institucionit të vet.

Koha që shpenzon koordinatori vendor në këtë rast për shqyrtimin e informacionit - ... orë.

- Koha që shpenzon koordinatori vendor për t'u siguruar që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës - ... orë.
- Koha që harxhon për t'u siguruar që të kryhen të gjitha llojet e ndërhyrjeve të nevojshme në përputhje me ligjin - ... orë.
- Koha që harxhon për bashkërendimin dhe organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga struktura përgjegjëse për dhunën në familje të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin - ... orë.
- Koha e harxhuar për informimin e anëtarëve të komunitetit - ... orë.
- Koha e harxhuar për informimin e profesionistëve - ... orë.
- Koha e harxhuar për informimin e organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje - ... orë.
- Koha e harxhuar për shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuere për dhunën - ... orë.
- Koha e harxhuar për hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip - ... orë.

- Koha e harxhuar për propozimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në komitetin drejtues për miratim në parim - ... orë.
- Koha e harxhuar për paraqitjen e raporteve mujore, tremujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues - ... orë.
- Koha e harxhuar për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje - ... orë.
- Koha e harxhuar për identifikimin e protokolleve ekzistuese në komunitet ose marrëdhënieve informale bashkëpunimi që rezultojnë të suksesshme - ... orë.
- Koha e harxhuar për propozimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së qeverisjes vendore - ... orë.

4. A ka hapa të tjerë që ju kryeni në lidhje me zbatimin e “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe VKM nr.334 datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkëpunimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, për të cilat unë nuk ju kam pyetur?

4.1. [Nëse po] Cilët janë këta hapa? Dhe sa kohë merr secili prej tyre?

Veprimtari/hapa të tjerë	Koha e marrë	Në 10 çështje, sa shpesh e bëjnë këtë?

5. Çfarë burimesh ju nevojiten në punën tuaj në zbatim të ligjit të dhunës? Çfarë do t'ju ndihmonte për ta bërë punën më të efektshme?

[Shënim për intervistuesin: Ju lutem, kuptoni shpjegimin dhe motivin pas çdo sugjerimi – pse dhe si ky burim do t'i përmirësonte gjërat?]

Ju falënderoj për kohën. Mund t'ju kontaktoj sërish nëse kam pyetje?

(Shënim për intervistuesin: Nëse i/e intervistuari/a është dakord, merrini nr. e telefonit.

Mbani shënim çdo informacion shtesë që del nga intervista.)

Aneksi 2.

Pamje nga veprimtaritë e organizuara për diskutimin e rezultateve të studimit.



Tryezë e organizuar me grupet e intervistuara,
Tiranë, 1 Qershor 2012.

ANEKS 2.



Tryezë e
organizuar
me grupet e
intervistuar,
Durrës, 21
Mars 2012



Tryezë e
organizuar
me grupet e
intervistuar,
Kukës, 3 Prill
2012

Tryezë e
organizuar
me
përfaqësuesit
e Komitetit
Drejtues të
Mekanizmit
të Referimit
të dhunës në
familje, Vlorë,
18 Qershor
2012.



Tryezë e
organizuar
me
përfaqësuesit
e Komitetit
Drejtues të
Mekanizmit
të Referimit
të dhunës në
familje, Korçë,
20 Shtator
2012.

ANEKS 2.



Tryezë e organizuar me përfaqësues të organeve të pushtetit qendror e vendor, për prezantimin e rezultateve të studimeve, Tiranë, 6 Nëntor 2012.